



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me shoqërinë civile për diskutimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” *(komision për dhënie mendimi)*.
2. Diskutimi dhe votimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2019” *(komision për dhënie mendimi)*.
3. Diskutimi dhe votimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” *(komision për dhënie mendimi)*.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Vilma Bello, Fidel Ylli, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Musa Ulqini, Besnik Baraj (zëvendësues), Anduel Xhindi (zëvendësues).

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Sezai Rrokaj.

Të ftuar:

Petrit Ymeri - Kryetar i Shoqatës së Botuesve Shqiptarë,
Linda Pino – përfaqësuese e Koalicionit për Arsimin në Shqipëri, ACE,
Zela Koka - përfaqësuese e MEDPAK, Shoqata e Prindërve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara,

Rivelino Çuno – përfaqësues i Organizatës Ballkan-Egjiptiane të Shqipërisë,
Hazis Doçi - përfaqësues i Shoqatës së Prindërve të Fëmijëve me Aftësi Ndryshe,
Emanuela Zajmi – përfaqësuese e Down Syndrome Albania Foundation,
Altea Lula - përfaqësuese e Qendrës “Për arsim cilësor”,
Besa Shahini - zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Florian Nurçe - përgjegjës në Sektorin e Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë,
Shpëtim Shehu – drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Kulturës,
Eridana Zoto - përgjegjëse në Sektorin e Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Kulturës,
Gentian Opre – drejtor i Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,
Ina Dhaskali – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Përshëndetje!

Javën e kaluar diskutuam dhe miratuam në parim projektbuxhetin për vitin 2019. Sipas procedurës, duhet të vazhdojmë diskutimin nen për nen. Sot kemi diskutimin me grupet e interesit.

Zoti Ylli, a është i plotë kuorumi?

Fidel Ylli- Kuorumi është i plotë, por unë vazhdoj të ndiej keqardhje që në një ditë të tillë, kur diskutohet buxheti nen për nen, opozita nuk është. Ajo duhej të vinte për të bërë vërejtjet e saj, por përsëri po bojkoton, megjithatë, kuorumi është.

Milva Ekonomi- Sot kemi ftuar dy grupe shoqatash. Kemi ftuar zotin Petrit Ymeri, kryetar i Shoqatës së Botuesve Shqiptarë, dhe zotin Gëzim Tafa, i cili nuk ka ardhur për arsye madhore.

Zoti Petrit, fjala për ju. Unë do të doja t'ju thosha që letrën tuaj e kemi marrë dhe ia kemi dërguar ministres. Do të donim edhe vërejtjet tuaja.

Petrit Ymeri - Faleminderit!

Në fakt, ne letrën ua kemi dërguar edhe anëtarëve të komisionit tuaj, edhe kryetares së komisionit.

Në këtë letër që ia kam dërguar Komisionit të Ekonomisë dhe Komisionit të Edukimit dhe Medies, kam ngritur dy çështje: së pari, TVSH-ja e librit është shumë e lartë. Asnjë vend europian nuk e ka TVSH-në 20%, qoftë vend i BE-së ose jo.

Përveç kësaj, ka edhe një anormalitet tjetër që ju, si ekonomiste që jeni, e kuptoni shumë mirë që kjo është një TVSH e parimbursueshme, sepse është 20% në blerje dhe 0% në shitje. Ky është një tatim që duhet t'i kthehet blerësit më të parë, por, në fakt, nuk funksionon kështu. Ne kemi kërkuar që kjo të ulet në kufijtë europianë që janë nga 4%-6% më e ulta ose më e larta, po themi. Në një takim që kam pasur me ministren e Kulturës para pak ditësh, Ministria e Kulturës ka avancuar dhe do të arrijë TVSH-në zero. Kjo do të ishte shumë e mirë, por, nëse do të jetë 4% ose 6%, është normale, sepse disiplinon të gjithë fashën e operatorëve që merren me librin. Në këtë situatë ku jemi kemi një pjesë të madhe të atyre që merren me librin, që nuk janë të përfshirë në sistemin e TVSH-së, si: kishat, xhamitë, OJF-të, që më shumë bëjnë evazion fiskal,

spekulime dhe konkurrojnë në mënyrë të pandershme shtëpitë botuese, që respektojnë ligjet dhe rregullat. Ne duhet të jemi në nivelin europian të TVSH-së së ulët dhe kjo natyrisht që do të reflektohet në të gjitha politikat librore të shtëpive botuese, dhe do të reflektohet edhe në cilësinë dhe çmimin e librit. Pra, në mënyrë direkte ose indirekte do të ndihmojë lexuesin.

Çështja e dytë është honorari, kurba e të cilit ka ardhur duke u rritur. Kështu, nga 5% në fillim të viteve '90, u rrit 10% në vitin 2005 dhe 15% në vitin 2014. Është një taksë shumë e lartë për krijuesit, për autorët dhe përkthyesit dhe për të gjithë fashën e krijuesve. Pra, së pari është e lartë dhe, së dyti, unë mendoj se shteti nuk ka ndonjë meritë në krijimtarinë e krijuesve, që t'i taksojë kaq shumë. Është shumë e lartë, madje në kufijtë e anormales dhe kudo do të kishte pasur reagime më të ashpra, por ne jemi mësuar me këto taksime, me rritje të sistemit fiskal e të tjera. Në vitin 2014 u rrit me 50% edhe tatimi mbi veprimtarinë e shtëpive botuese, që mund të ishte bërë një përjashtim. Nuk e kemi bërë këtë kërkesë, duke kërkuar barazi në të gjithë sistemin prodhues.

Këto janë dy çështjet që unë i kam drejtuar në emër të shoqatës së botuesve edhe Ministrisë së Kulturës, edhe Ministrisë së Financave, edhe komisioneve parlamentare të Edukimit & Medias dhe Ekonomisë.

Milva Ekonomi- Ne e kemi lexuar letrën tuaj dhe sa i përket çështjes së parë, që ka të bëjë me TVSH-në e librit, kemi edhe një mendim. Para pak kohe në diskutimin në parim të një projektligji për TVSH-në e produkteve të reklamës, për arsyen që ngarkohet nga njëra anë dhe nuk shkarkohet në anën tjetër, u mor në konsideratë që TVSH-ja të shkojë në masën 6%.

Ne do të bëjmë konsultimet tona me Komisionin e Ekonomisë.

Lidhur me tatimin që ju paguani për honorarët, kjo ka të bëjë me tatimin mbi të ardhurat personale. Në Shqipëri, siç e dini, nga një tatim i sheshtë, ai shkon në një tatim progresiv dhe nuk është vetëm për krijuesit, ndërkohë që Komisioni i Ekonomisë është duke diskutuar një paketë fiskale. Këto ditë ka qenë diskutimi i paketës fiskale të re dhe ende çështjet janë në diskutim. Nuk ka një përgjigje definitive për këtë. Ne, pas diskutimit në parim të projektbuxhetit, do të paraqesim pranë Komisionit të Ekonomisë një propozim të dytë, për ndryshimet që mund të bëjmë në secilin nen, ku do të shikojmë edhe çështjen e TVSH-së, se mos e bëjmë bashkë me procedurën e reklamave dhe të shikojmë se çfarë përgjigje do të kemi.

Sa u takon honorarëve për krijuesit, është një çështje që nuk e marrim dot përsipër ta diskutojmë tani, sepse çështjet janë. Përtej këtij momenti edhe ne e shohim si pjesë që duhet

stimuluar, por mbase kërkon diçka që duhet ta mendojë Ministria e Financave, edhe për mënyrën si regjistrohet e drejta e autorit dhe si tatohet ajo.

A keni ndonjë pyetje?

Në diskutimet e projektbuxhetit të këtij viti kemi një çështje që ka të bëjë jo vetëm me të ardhurat personale, por edhe me dividendin. Pjesa e të ardhurave nga dividenti, që mund të lidhet me ecurinë e shtëpive botuese ose të tjera kompanive që lidhen me fushën e botimit, është parashikuar të jetë në masën 8%, nga 15% që ishte. Kjo është një gjë që duhet ta merrni shënim, ta shikoni si shkon, se mbase përfaqësimi i së drejtës së autorit mund të jetë i organizuar në forma të tilla, që mund të ketë një përfitim nga ulja e taksës së dividendit nga 15% në 8%. Mbase duhet parë edhe më nga afër organizimi i shpërndarjes së krijimtarisë letrare.

Petrit Ymeri- Së pari, ju falënderoj për trajtimin e çështjes.

Së dyti, dua t'ju them se çështja e leximit duhet të na shqetësojë të gjithëve si shoqëri, jo thjesht nga të dhënat tronditëse, për të cilat mua më vjen keq që shteti shqiptar i ka trajtuar sikur janë asgjë. Nga anketimi që Shoqata e Botuesve ka bërë këto 4 vjetët e fundit, vihet re një situatë trishtuese, leximi po bie në mënyrë katastrofike. Nga anketimi që bëri INSAT-i dhe nga të dhënat e anketimit tonë, mbase kemi ndjekur metodologji të ndryshme, por janë të njëjtët rezultate. Po bie leximi dhe kjo ka pasoja të mëdha, të cilat i shohim sot, por shumë prej tyre do t'i shohim nesër.

Bibliotekat tona janë në gjendje të mjerueshme, bibliotekat e shkollave po ashtu. Ka 6 vjet që nuk është bërë asnjë furnizim i bibliotekave shkollore. Kam folur disa herë në Ministri të Arsimit, edhe me ministren, por nuk është bërë asnjë investim. Investimi i fundit për pasurim bibliotekash është bërë në vitin 2012. Janë bërë 3 vjet me radhë, ka pasur abuzime të cilat i kemi denoncuar që atëherë edhe publikisht, me thënë të drejtën, por janë bërë. Tani është vënë një shumë prej 200 milionë lekësh të vjetër këtë vit, që, në fakt, është një shumë minimale. Po të shkoni në bibliotekat e shkollave, është një turp. Për shembull, biblioteka e shkollës “Osman Myderizi” është një katastrofë. Shteti ka detyrim kushtetues t'iu japë nxënësve dije dhe t'i largojë nga rruga. Sa do të fitojmë ne nga kjo punë. Atë që ne kemi humbur në këto 25 vjet do të na duhen edhe 25 vjet të tjerë ta rikuperojmë. Kur po bisedoja me zonjën Mirela, më tha se isha optimist kur thashë se duhen 15 vjet, në fakt, duhen më shumë. Duhet bërë investime të mëdha dhe të menduara.

Ne kemi kërkuar bashkëpunimin e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës dhe shohim një vullnet shumë të mirë te Ministria e Kulturës, për hir të së vërtetës, por, duke qenë aktorët kryesorë

të kësaj pune dhe që e njohim situatën, mendojmë që duhet të punojmë të gjithë së bashku. Të gjithë e kuptojmë që një popull i kulturuar, një rini e kulturuar, i përballon sfidat e sotme dhe të nesërme më thjesht. Jemi përballë sfidave të ndryshme, si: droga e krimi, por duhet të bëjmë investime për këtë punë. Kemi qytete të mëdha pa biblioteka. Qyteti i Tiranës, për shembull, nuk ka bibliotekë. Bibliotekat e lagjeve janë për faqe të zezë, nuk kanë libra. Duhet të heqim dorë nga kjo politikë, politikë fasdash, duhet të bëjmë politika librare. Ju jeni deputetë dhe duhet të ndërhyni me përvojën tuaj. Unë e kuptoj situatën fare mirë. Mbase po e diskutoj në mënyrë pasionante. Durrësi nuk ka bibliotekë, është bërë në plan për t'u prishur që para 40 vjetësh. Durrësi është bërë beton i gjallë, por nuk bëhet një bibliotekë qyteti. Nuk po flasim për fshatrat që nuk kanë biblioteka fare. Po edhe aty jetojnë njerëz. Në fakt, kështu flitet, nëse nuk duam t'i bëjmë qejfin njëri-tjetrit.

Milva Ekonomi - Derisa kemi filluar fushatën kombëtare “Të lexojmë së bashku” i bie që ka një situatë.

Petrit Ymeri- Këto nuk bëhen me fushata leximi, ku del e reciton kryetari i bashkisë dhe ministri. Nuk janë të duhurat. Kryetari i bashkisë e ministri të bëjnë punën që duhet të bëjnë.

Milva Ekonomi- Më falni, zoti Ymeri, unë nuk iu ndërpreva.

Po them se secili duhet të bëjë diçka, por leximi nuk ka rënë vetëm në Shqipëri, është një fakt që leximi ka rënë. Po shikoj të dhënat e INSTAT-it si e kalon kohën një njeri në Shqipëri. Gratë kalojnë 16 minuta në ditë për të lexuar, ndërsa burrat harxhojnë 11 minuta në ditë për të lexuar. Kështu që ne duhet të fillojmë të mendojmë për fëmijët e vegjël, si t'u shtojmë dashurinë për librin. Ju keni të drejtë. Mbase duhet futur në kurrikul leximi i librit, siç e kemi bërë ne dikur, por, nga ana tjetër, unë nuk e di nëse shtëpitë tona botuese i plotësojnë të gjitha detyrimet që kanë për dërgimin e librit pranë Bibliotekës Kombëtare ose të tjera enteve. Kur unë punoja në INSTAT, si masë e ISBN-ve që bënim, duhej të dërgonim 5 kopje në Bibliotekën Kombëtare.

Mendimi tjetër që kam unë, pavarësisht mendimit tuaj për kryetarin e bashkisë, hapja e bibliotekave të reja në Tiranë jo vetëm që ka nxitur idenë e leximit, pavarësisht nga grupmoshat, por ka bërë që edhe bizneset përkrah bibliotekave, kanë shtuar fondin e bibliotekave. Tani qeveria po vë 200 milionë lekë; ky është viti i parë që ka dhënë këtë lloj mundësie, viti që vjen mbase duhet të ketë edhe më shumë mundësi. Por të gjithë aktorët duhet të marrin rolin e tyre, sepse leximi në këto norma është në Shqipëri, por nuk është vetëm çështje shqiptare, që shqiptarët

lexojnë kaq pak. Me atë që di unë nga literatura botërore, them se është çështje mbarëglobale. Leximi ka rënë në të gjithë botën, por ne duhet t'ia shtojmë brezit të ri dashurinë për lexim.

Petrit Ymeri- Unë nuk jam dakord me pikëpamjen tuaj që leximi ka rënë në të gjithë botën. Në Europë lexohet gjithnjë e më shumë.

Milva Ekonomi- Unë nga Italia dëgjova që kishte rënë.

Petrit Ymeri – Ju keni dëgjuar disa të dhëna të deformuara nga Ministria e Kulturës.

Milva Ekonomi- Jo, unë i dëgjova nga zotëria që kishit në panair.

Petrit Ymeri- Leximi po shkon në rritje, sepse ka vëmendje të institucioneve dhe është detyrim kushtetues i shtetit t'iu japë nxënësve libra. Ai duhet të ndjejë presionin e librit. Ta ketë librin aty dhe nuk ka rëndësi nga kush ndikohet: nga shoqja, mësuesja apo nga të tjerë. Ju jepjani librin pranë bibliotekës së shkollës ose të lagjes, sepse nuk po marr përsipër të bëj analistin, por më shumë se 50% e familjeve shqiptare nuk janë në gjendje të blejnë libra, prandaj shteti është i detyruar t'u japë librat. Kjo sëmundje që na ka pllakosur, ka nisur nga vitet '91-'92 dhe nuk ka të bëjë vetëm me këto 3-4 vjetët e fundit. Po jua them gjërat siç janë për të kuptuar situatën, e cila është agravuar nga viti në vit, nga 5-vjeçari në 5-vjeçar, prandaj duhet ta kuptojmë çështjen dhe të bashkëpunojmë, dhe të shohim se çfarë mund të bëjmë. Fushatat e leximit janë të mira, por kjo gjë nuk bëhet me fushata. Ato janë vetëm për të dalë në televizion dhe për të folur, për të recituar, për të kënduar, për të bërë koncerte, por me ato paratë që merren nga koncertet, mund të ishin mbushur të gjitha bibliotekat e Shqipërisë, por kjo është një histori tjetër.

Unë kam takuar me dhjetëra mësues dhe me qindra nxënës, të cilëve u mbushen sytë me lot se nuk kanë libra. Kur shkojmë dhe bëjmë takime, mësuesit na thonë: “Na falni disa libra”. Kjo është situata aktuale dhe gjërat po i them ashtu siç janë. Ne vijmë nga një periudhë tjetër, ku shteti ishte më pjesëmarrës, por ajo kohë ka kaluar, por dua t'ju them se këto janë detyrime të shtetit. Ka familje dhe shkolla që e përballojnë, por ka edhe nga ato që nuk e përballojnë. Më kujtohet një shkollë në të cilën isha vjet, megjithëse kam parë 20 të tilla në Jug, që nga Vlora, Saranda, Gjirokastra, Përmeti, Tepelena, shkolla “Daut Sheme” në Sarandë, me 1200 nxënës, e cila kishte një bibliotekë sa 1/10 e kësaj dhome, pa libra, me mësues të pasionuar, por të varfër, të cilët ishin me këpucë të grisura, por ata kërkonin me ngulm libra për nxënësit e tyre.

Nuk ka fare rëndësi se çfarë mendoj unë për kryetarin e bashkisë të një qyteti apo të një qyteti tjetër, por dua t'ju them se Tirana nuk ka një bibliotekë qyteti, Durrësi po ashtu, prandaj ne duhet të mendojmë se si ta përballojmë këtë situatë.

Sa i takon asaj që thatë ju për kopjet e Bibliotekës Kombëtare.

Së pari, me ato kopje është bërë një abuzim i madh, gjë që ndodh vetëm në Shqipëri, sepse ato janë kopje dhe kjo është një vjedhje që u është bërë subjekteve, dhe në ligjin e ri kjo gjë do të ndryshohet. Këto kopje nuk janë për lexuesit, por janë kopje dokumentimi dhe si në të gjithë botën ekziston vetëm një kopje e tillë, jo nga 5 kopje. Kjo është një reminishencë që ka ardhur nga sistemi i kaluar, ku shteti kishte në dorë shtypshkronjat, bibliotekat dhe shtëpitë botuese, ndërsa në kohët e sotme këto nuk i ka shteti, por janë biznese dhe ato japin vetëm një kopje. Madje, po jua theksoj këtë, bota ka vetëm një kopje dhe e ka facultative: ose e blen, ose e fal; ai që do, e fal dhe ai që e do, e blen. Shtetet e Bashkuara e kanë me blerje, por kjo nuk ka rëndësi.

Ne i kemi propozuar ministres së Kulturës që kur qyteti të ketë bibliotekë, atëherë një kopje e librave tanë do të jetë për Bibliotekën Kombëtare dhe një për bibliotekën e qytetit, por jo për lexim. Biblioteka Kombëtare duhet të ketë fonde për të blerë libra, po ashtu edhe të gjitha bibliotekat e tjera. Para disa kohësh kjo bibliotekë u mbyt nga uji dhe askush nuk mbajti përgjegjësi, dhe nuk u morr asnjë masë. Madje u tha se atje ishin disa libra rusisht, sikur këta libra ishin për t'u hedhur në Lanë. Kanë ndodhur dy gjëra të dënueshme në Bibliotekën Kombëtare, ku një herë ka rënë zjarri dhe një herë uji, por asnjë masë nuk u mor dhe këto çështje u mbyllën.

Botuesit duhet të shlyejnë detyrimet që kanë, por së shpejti do të diskutojmë edhe për disa përmirësime në ligjin për librin. Unë kërkoj nga ju më shumë vëmendje, sepse kur është diskutuar ligji për të drejtën e autorit, ku relatores ka qenë zonja që është e pranishme këtu, janë lejuar shumë gabime, pasojat e të cilave po i shohim sot.

Ju lutem, vërejtjet dhe sugjerimet që ne ju bëjmë, duhet t'i merrni parasysht, sepse ne jemi specialistë! Mos merrni si të mirëqenë çdo gjë që ju vjen nga zyrat e shtetit. Ne jemi këtu për të njëjtin qëllim dhe për të njëjtën gjë. U bë rishikimi i ligjit "Për mbrojtjen e së drejtës së autorit" dhe ai kishte mjaft defekte, të cilat i shohim sot e kësaj dite. Prandaj, edhe për ligjin e librit, ne kemi biseduar me ministren dhe për shumë gjëra kryesore jemi në një mendje, prandaj gjërat duhen bërë ashtu siç duhet, pasi edhe modelet i kemi gati.

Milva Ekonomi – Sa u takon shënimeve që ju keni bërë për projektbuxhetin e këtij viti, siç edhe ju njoftova, do ta shohim edhe pjesën e TVSH-së në komision. Sa i takon pjesës së tatimfitimit që ju keni për krijimtarinë, do ta kemi si pjesë të diskutimit të përgjithshëm që ka paketa e tatimeve, e fiskut, për vitin 2019-të. Kur të punojmë me ligjin e ri të librit, për prodhimin

e librit të leximit, nuk e di se si do ta ketë emrin ligji i ri, patjetër që do të kemi rastin t'ju dëgjojmë dhe të komunikojmë për ndryshimet pozitive që duhen bërë për gjithë sektorin.

Petrit Ymeri – Doja të bëja një ndërhyrje të vogël për ligjin, për honoraret. Unë e kuptoj që kjo lidhet me paketën fiskale dhe normalisht me tatimin mbi të ardhurat. Siç edhe jua thashë edhe më parë, njerëzit që merren me krijimtari, autorët, përkthyesit nuk janë njerëz “të pasur”, por janë njerëz që e bëjnë punën e tyre me vështirësi dhe shpeshherë e bëjnë në kohën e lirë. Pra, në qoftë se ata marrin 1 milion lekë, t'u heqësish 150 mijë kjo është diçka e rëndë. Unë e di këtë gjë, sepse tatimin e mbajmë ne dhe kur e derdhim atë...

Milva Ekonomi – Tatimi fillon mbi shumën 1 milion e 300 mijë lekë të vjetra?

Petrit Ymeri – Tatimi mbi honoraret për krijimtarinë fillon nga 2 lekë, kështu të paktën na e kërkon zyra e tatimit. Kjo gjë për mendimin tim duhet parë, megjithatë ju i dini më mirë dhe nuk po ngul këmbë. Një pjesë e këtyre krijuesve janë të rinj dhe për këtë arsye ata nuk duhet të goditen në punën krijuese që bëjnë, sepse brenda kësaj pune ata kanë pasionin dhe të gjitha gjërat e tjera. Unë mendoj se duhet të gjejmë një mënyrë për t'i përkrahur këta krijues të rinj.

Këto pak a shumë janë mendimet tona, por jam i sigurt në dashamirësinë tuaj dhe për këtë arsye po ju flas hapur.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ju falënderoj! Do t'ju lutesha që sa herë të keni probleme të tilla për t'i ndarë me ne, të mos nguroni të na i sillni dhe më pas ne do t'i trajtojmë në komision.

Ju falënderoj!

Punë të mbarë dhe suksese.

Vijojmë me të ftuarit e tjerë.

Ju falënderoj për prezencën tuaj!

Është momenti kur ne po diskutojmë projektbuxhetin për vitin 2019-të. Deri tani është bërë diskutimi në parim i projektbuxhetit, ndërsa tani do të fillojmë diskutimin nen për nen të tij, ku mund të ndërhyjmë dhe të bëjmë propozimet tona për disa ndryshime të mundshme në këtë projektbuxhet.

Disa prej jush nuk e kanë për herë të parë ardhjen në komisionin tonë, prandaj mendoj se ju e dini që në shënimet që marrim, i dërgojmë pranë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Zakonisht këtë gjë e bëjmë, pasi ju dëgjojmë dhe diskutojmë me ju çështje që janë të rëndësishme për aktivitetin tuaj vjetor, të cilat kanë nevojë të mbulohen me një projektbuxhet të caktuar.

Sa i takon pjesës me grupet e interesit që përfaqësojnë shoqërinë civile, kemi thirrur disa shoqata që kanë bërë kërkesë, duke u nisur edhe nga eksperiencia e viteve të kaluara. Disa nga këto shoqata janë: Koalicioni për Arsimin në Shqipëri, përfaqësuar nga zonja Linda Pino; Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri; Shoqata e Prindërve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara, e përfaqësuar nga zonja Zela Koka; Organizata Ballkane-Egjiptiane e Shqipërisë, e përfaqësuar nga zoti Rivelino Çuno; Shoqata e Prindërve të Fëmijëve me Aftësi Ndryshe, e përfaqësuar nga zoti Azis Doçi; Down Sindrom Albania Foundation, e përfaqësuar nga zonja Emanuela Zajmi; Qendra për Arsimin Cilësor, e përfaqësuar nga zonja Altea Lula.

Të gjithë përfaqësuesit do ta marrin fjalën me radhë. Një pjesë e tyre na kanë dërguar materiale me shkrim, prandaj kërkoj që të referoheni në mënyrë të përmbledhur. Ju lutem, përpiquni ta menaxhoni kohën, që ne, më pas, të kemi kohë të mjaftueshme për të hedhur shënimet për raportin që duhet të dërgojmë!

Faleminderit!

Linda Pino – Zonja Ekonomi, ju falënderoj për ftesën!

Falënderoj dhe gjithë anëtarët e Komisionit të Edukimit dhe Mjetet e Informimit Publik!

Është kënaqësi të jemi në këtë tryezë dhe të flasim për buxhetin për arsimin, sidomos për fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri.

Në emër të Koalicionit për Arsimin në Shqipëri ne kemi dërguar disa materiale, përfshi këtu edhe një studim për 10 vjetët e fundit të buxhetit të shtetit, si ka qenë ai, si ka qenë trendi i këtij buxheti dhe çfarë i ka munguar arsimit të fëmijëve. Një buxhet i munguar për fëmijët ka pengesat e veta, për t'u siguruar atyre një arsim cilësor publik dhe gjithëpërfshirës.

Sa i përket buxhetit të shtetit për vitin 2019, ajo që unë dua të ngre është procesi që ka ndjekur Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila është ndër të vetmet ministri që ka organizuar brenda afateve kohore të dyja konsultimet me shoqërinë civile, sa i takon buxhetit të shtetit qoftë për vitin 2019, por edhe për atë afatmesëm 2019-2020.

Për vitin 2019, shqetësimi që ne kemi si koalicion është buxheti i ulët, për të cilin shteti shqiptar do alokojë buxhet edhe për këtë vit. Nga këndvështrimi që i kemi bërë buxhetit, si dhe relacioni që është dërguar nga Ministria e Arsimit, vëmë re se buxheti i Ministrisë së Arsimit ndaj produktit të brendshëm bruto është në masën 2,24%. Më parë ai ka qenë në masën 2,33%, ndërsa këtë vit është më i ulët, me 2,24%. Gjithmonë, flas për buxhetin e arsimit, për zërat e saj buxhetorë,

por duke hequr këtu të gjitha buxhetet që shkojnë më pas te ministritë e tjera, të cilat merren me arsimin.

Ky buxhet i ulët, i cili në pjesën më të madhe të tij shkon për sigurimin e pagesave apo të sigurimeve shoqërore për të gjithë mësuesit, bën të mundur që shpenzimet kapitale sa i takon investimeve të reja, pajisjes me laboratorë, mbulimi me internet për të gjitha shkollat të cenohen. Këtë vit është parashikuar edhe rritja e numrit të shkollave me bazë komunitare, por ne nuk e shohim të reflektuar në buxhetin e Ministrisë së Arsimit mbështetjen financiare për këtë nismë. Duke u nisur nga këndvështrimi ynë, kjo gjë bën të mundur që kjo nismë të mos ketë atë sukses për të cilin është shkruar në letër dhe për të cilin kanë punuar të gjithë aktorët që janë pjesë e këtij procesi.

Duke filluar nga 1 janari 2015 dhe në vijim zëri buxhetor “arsimi profesional” i është hequr Ministrisë së Arsimit dhe i është bashkuar Ministrisë së Mirëqenies në vitin 2017 dhe, më pas, Ministrisë së Financave. Ne e shohim si një cirk buxhetor dhe në këndvështrimin tonë është e vështirë për t’u kuptuar dhe për t’u argumentuar se si shkon ky investim sa u përket shpenzimeve korrente dhe kapitale. Pra, sa është lidhja me stafin, puna dhe politikat e Ministrisë së Arsimit, sepse fondi menaxhohet nga një ministri tjetër. Ajo që ne si koalicion e shohim si tepër të rëndësishme është që ky zë buxhetor duhet t’i kthehet përsëri Ministrisë së Arsimit, sepse flitet për arsimin dhe jo për zëra buxhetorë të ministrive të tjera.

Shërbimi psiko-social. Sipas relacionit është kërkuar një dyfishim i numri të psikologëve. Ne nuk e shohim këtë gjë të reflektuar në buxhet, por shohim se është e njëjta shifër si vitin e kaluar. Gjithashtu, nuk shohim të reflektuar trajnimin e mësuesve të shërbimit psiko-social. A janë të gjitha këto të mbuluara nga arsimi për 2019-ën apo psikologët duhet të paguajnë për të qenë të trajnuar?

Një tjetër pikë, të cilën e kërkojmë edhe nga Ministria e Arsimit, nëse ajo do të ketë një përgjigje, ka të bëjë me pagesën e orëve shtesë për mësuesit, të cilët janë pjesë e shkollës “Qendër komunitare”. Pagesa e tyre bëhet duke plotësuar normën mësimore apo kjo pagesë bëhet gjithmonë përkundrejt pagesës që marrin ata në total në muaj?

Kohë më parë Banka Botërore ka bërë publik një indeks në lidhje me zhvillimin e kapitalit human. Përveç përparësive që ka bërë Shqipëria sa i përket përmirësimeve në arsim, kjo e lidhur me rezultatet e Pisës, sa i takon cilësisë së arsimit rezultatet e saj janë nën nivelin e të ardhurave.

Pra, nëse ne investojmë shumë pak në arsim, atëherë edhe cilësia në arsim do të jenë në nivelin e të ardhurave që ka vendi.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Në komision kemi të pranishëm edhe përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit. Mendoj se është më mirë ta marrin fjalën të gjithë përfaqësuesit e shoqatave që janë prezent dhe, më pas, ju të bëni ndërhyrje sa u takon këtyre çështjeve, pasi ne së bashku me Ministrinë e Arsimit i kemi trajtuar shifrat në një moment tjetër.

Rivelino Çuno – Përshëndetje!

Unë jam përfaqësues i Komunitetit Egjiptian në Shqipëri. Ne jemi të ndërgjegjshëm që Shqipëria është e varfër dhe buxheti i këtij viti ashtu si buxhetet pararendëse, duhet të kujdeset për një pamundësi varfërie dhe nevojash. Sidoqoftë, egjiptianët e Shqipërisë vuajnë dyfish. Nga se vuajnë? Ata vuajnë varfërinë si gjithë shqiptarët, por edhe diskriminimi ndaj tyre vjen si rezultat i padijes dhe i mospërgatitjes kulturore. Ndaj, mendoj se do të ishte me rëndësi që në buxhetin e këtij viti dhe në vijim të shihej mundësia për parashtrimin e disa zërave, nëpërmjet të cilave adresohet një pjesë e problematikave të komunitetit egjiptian.

Propozimet tona janë:

E para, duke qenë se ne egjiptianë jemi një ndër 5 prioritet për integrimin në Bashkimin Europian, të parashikohet një kuotë punësimi në shtet dhe në privat dhe sa i takon këtij të fundit të bëhet me lehtësime apo subvencioneve nga shteti njëlloj sikurse parashtrohet për komunitetet e tjera. Propozimet që parashtrojnë një kuotë të tillë së paku 1 egjiptian i punësuar për institucion apo kompani private.

E dyta. A është parashikuar që këtë vit të rritet kuota për studimet universitare dhe masterat, por edhe të shkollimit në shkollat e mesme për komunitetin egjiptian?

Ne propozojmë që këtë vit së paku të rritet me 50% kuota e deritanishme për komunitetin egjiptian.

E treta. A është parashikuar një sektor i posaçëm në Ministrinë e Arsimit, të cilët kujdesen dhe ndjekin të gjitha problematikat e komunitetit egjiptian e pse jo edhe të atij rom, si dhe të komuniteteve të tjera të marginalizuara?

Ne propozojmë që të ngrihet një sektor i posaçëm për punësim dhe përfaqësimin e komunitetit egjiptian në këtë sektor, gjë që do të ishte një zgjidhje optimale.

E katërta. A është parashikuar ndonjë rritje për ndihmën sociale dhe paketën e subvencionimeve nga shteti për familjet e varfra dhe të diskriminuara të komunitetit egjiptian?

Ne propozojmë që edhe vetë ndihma sociale apo edhe ndihmat e tjera mbështetëse nga shteti të zgjerohen, sepse familjet egjiptiane jetojnë në varfëri ekstreme.

E pesta. A është e mundur që pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Çështjeve Sociale të ngrihet një sektor i posaçëm për marrjen e një kujdesi të posaçëm që egjiptianët të rimbursohen për ilaçet?

E gjashta. Ne propozojmë që Ministria e Shëndetësisë dhe e Çështjeve Sociale të ngrejë një trajtim profesional për komunitetin egjiptian për të njohur shqetësimet e drejtpërdrejta që kanë për sa i përket shëndetësisë.

7. Librat falas. Propozojmë që pranë çdo shkolle fillore 9-vjeçare apo të mesme, të parashikohet të jetë edhe një psikolog social i trajnuar dhe specializuar për çështjen e komunitetit egjiptian.

Këto janë propozimet tona.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Po, zonja Zajmi.

Emanuela Zajmi – Mirëdita!

Quhem Emanuela Zajmi nga Fondacioni Down Syndrome Albania Foundation, njëkohësisht anëtare e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Edhe me MEDPAK, duke qenë se jemi shoqatë prindërore, jemi konsultuar dhe sot të dyja do të bëjmë komplementaren e njëra-tjetrës, pra kërkesat vijnë njëzëri.

Për parantezë, para se të flasim specifikisht, duam të theksojmë se për sa i përket arsimit gjithëpërfshirës dhe specifikisht fëmijëve me aftësi të kufizuara, dëshirojmë të kuptoni deri në filozofi të kësaj çështjeje. Pra, ideja është që, nëse e kemi pasur një strategji kombëtare të arsimit, e cila do të rishikohet dhe po përgatitet e reja për periudhën 2020-2024, duam të theksojmë se, nëse buxheti nuk është i duhur për arsimin gjithëpërfshirës dhe për fëmijët me aftësi të kufizuara, çfarëdolloj strategjie kombëtare të bëjmë, do të mbetet e paarritur nëse nuk i ka instrumentet financiare për t'u realizuar.

Gjithashtu, duam të theksojmë se në kuadër të kësaj filozofie, është koha që për arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara çdo gjë në buxhet të jetë si një zë më vete për arsimin e tyre. Kjo do të na bëjë më të matshëm për të parë vit pas viti se si i arrijmë objektivat.

Pika 3, që është më e rëndësishmja, ju duhet ta dini që në kuadër të ligjit të aksesueshmërisë, në çdo ministri, me urdhër të ministrit përkatës, caktohet një nëpunës që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar. Organet e qeverisjes vendore emërojnë një ose disa punonjës vendorë, që merren me këto çështje. Në shumë institucione kjo ka dështuar. Sot do të flasim për çështjet e arsimit dhe duam të theksojmë edhe një herë se është shumë e domosdoshme të ketë departamente ose persona kyç, që trajtojnë arsimin gjithëpërfshirës si koncept, por edhe specifikisht, arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Mendojmë se këto 3 pika kryesore janë shumë të rëndësishme për të kaluar më tej specifikisht për gjërat që kemi vënë re në relacion dhe në buxhet.

Shpesh, kur flasim për arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, flitet kryesisht për mësuesit ndihmës. Duhet të kemi të gjithë parasysh se të realizosh objektivat e një arsimi cilësor për këta fëmijë, nuk do të thotë të fokusohesh vetëm në një komponent, i cili mundëson arsimin gjithëpërfshirës. Pra, kur bëjmë buxhete duhet të kemi parasysh filozofinë që folëm, duhen ngritur kapacitete në të gjitha drejtimet për arsimimin kur bëhet fjalë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe jo vetëm të theksojmë mësuesit ndihmës. Sigurisht, është për t'u vlerësuar dhe falënderuar fakti që vërtet Ministria e Arsimit i ka marrë parasysh objektivat për sigurimin e mësuesve ndihmës dhe tashmë nga statistikat për periudhën 2018-2019 dhe numri i tyre ka arritur në 590-600. Sigurisht që e vlerësojmë këtë, por kjo nuk është e mjaftueshme nëse duam ta çojmë përpara cilësinë e këtij arsimi. Mungon zëri i trajnimit për mësuesit dhe të gjithë stafit akademik në arsim, sa i përket arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në relacion përmendet rritja e numrit të mësuesve dhe gjithashtu një zë i parashikuar për trajnimin e 200 mësuesve, por ne mendojmë se ky numër është shumë i vogël për nevojat e tanishme. Nuk ka zë specifik për rritje të stafit të shërbimit psiko-social për arsimin parashkollor dhe 9-vjeçar, ndryshe nga rezultati i parashikuar për arsimin e mesëm dhe të lartë. Për këtë arsim, në buxhet dhe relacion është vendosur: "Shërbimi psiko-social, aktualisht në shkollat e arsimit të mesëm dhe të lartë, ofrohet sipas kësaj norme një psikolog dhe punonjës social për çdo 2500-3500 nxënës. Deri në vitin 2021 çdo shkollë e mesme do të ketë një psikolog ose një punonjës social". Pra, nëse e shikojmë këtë gjë për arsimin e mesëm, nuk e shikojmë për arsimin 9-vjeçar. Gjithashtu, edhe për këtë që është vendosur, shohim të pakrahasueshëm këtë që keni vendosur, sepse për këtë objektiv nuk është e qartë për ne si do të ndryshojë raporti psikolog, punonjës social, për numër nxënësish për ta bërë rezultatin të krahasueshëm.

Le të kthehemi specifikisht te fëmijët me aftësi të kufizuara, duhet ta dini se ka një ligj, i cili detyron kalimin e shkollave speciale për këta fëmijë në shkolla burimore. Kjo gjë nuk po realizohet. Edhe në këtë buxhet nuk shikojmë një buxhet specifikisht të vendosur për ta bërë të mundur këtë gjë, pra që shkollat speciale, që janë në kundërshtim me konventën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, nuk ka një buxhet specifik për të kaluar në qendra burimore. Për të mbetur brenda kësaj logjike, mendojmë se, sidomos kur parashikohet një buxhet për fëmijët me aftësi të kufizuara, buxhet i cili shpenzohet për shkollat speciale, do të duhet një zë buxhetor, i cili mund t'u bashkohet tentativave për të pasur një arsim cilësor për aftësinë e kufizuar. Pra, si fillim të kemi një zë buxhetor për t'i kthyer shkollat speciale në qendra burimore. Buxheti që është shpenzuar deri më tani nuk i ka arsimuar në mënyrën e duhur dhe në përputhje me konventat për këta persona.

Edhe Linda e përmendi dhe nuk dua të zgjatem, shkollat komunitare nuk kanë një buxhet specifik. Ndërkohë, për aftësinë e kufizuar ne kemi monitoruar dhe kemi parë që nuk ka asgjë të mirëstrukturuar, që në qasje ka fëmijët me aftësi të kufizuara për t'i përfshirë në kuadër të shkollave si qendër komunitare.

Buxheti i sportit. As aty nuk shikojmë ndonjë rezultat apo objektiv për përfshirjen e fëmijëve apo të rinjve me aftësi të kufizuara në sport dhe mbështetjen e talentëve. Fondacioni ynë gjatë viteve të fundit ka pasur një mbështetje preferenciale, le të themi, për një të ri me Sindromën Down, që e kemi të talentuar në not. Dy vite radhazi na ka mbështetur për ta çuar edhe në kompeticione kombëtare, jemi falënderues për këtë, por mendojmë se është koha për t'u parë strategjikisht mbështetja e talentëve dhe involvimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në sport, pasi ka studime botërore dhe europiane që, kur një person me apo pa aftësi të kufizuara, është involvuar me sport, ka një kosto më të ulët edhe për shëndetin, aq më tepër te fëmijët me aftësi të kufizuara, sporti ndihmon jo vetëm në një shëndet më të mirë, por edhe në gjithpërfshirje dhe është një komponent shumë i rëndësishëm.

Kërkojmë që kjo gjë të merret më seriozisht, sepse edhe Kryeministri ka parashikuar vizione shumë të qarta për sportin në lidhje me aftësitë e kufizuara, por në buxhet, ky zë nuk është i diktuar dhe i qartë.

Në buxhetin e parashikuar për nxënësit me aftësi të kufizuara, objektiv tjetër është rritja e numrit të këtyre nxënësve që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale nga 90 nxënës në vitin 2018, në 120 në vitin 2021.

Ju duhet të kuptoni që kërkohen disa kushte dhe kritere për ta bërë edhe arsimin profesional të aksesueshëm. Në buxhet nuk shohim asgjë të specifikuar për rritjen e kapaciteteve të atyre që punojnë në këtë degë të arsimit dhe bashkohem me shqetësimin e Lindës për një ping-pong mes ministrive se cila do ta marrë këtë pjesë të arsimit në përgjithësi.

Duhet përshtatur kurikulat në të gjitha drejtimet kur kemi të bëjmë me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe sidomos në arsimin profesional, një nga arsimet me vlerë, si një mundësi shumë e mirë që nesër të hidhen në tregun e punës. Pra, arsimi profesional për këta persona duhet të jetë më i vëmendshëm, sepse, ndryshe nga një fakultet, ku mund të shkojnë të gjithë, një zanat apo profesion në shkollat profesionale e bën të mundur integrimin në tregun e punës dhe pavarësinë e një personi me aftësi të kufizuara.

Ju lutem, t'i ndajmë gjërat specifikisht në mënyrë që të arrijmë bashkërisht të bëjmë gjëra të matshme e të shohim rezultate vit pas viti. E dimë që gjërat nuk bëhen sot për nesër, por mendojmë se është koha për t'i pasur në mënyrë më të specifikuar objektivat për aftësinë e kufizuar dhe buxhetin krahas tyre.

Në relacionin për buxhetin e aksesueshëm përmendet:

- Pagesë për interpret të gjuhës së shenjave, e cila arrin në vlerën prej 400 mijë lekësh.
- Pagesa për printimin e ligjit në formate të aksesueshëm *breil* në vlerën prej 12 milionësh lekësh.

Ne kërkojmë të shtohet një zë specifik për punësimin e një specialisti në çdo ministri, në nenin 14 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Është momenti të ndajmë në çdo ministri apo institucion shtetëror, siç e parashikon ligji, persona të dedikuar që kanë në përgjegjësinë e tyre çështje të aftësisë së kufizuar, sidomos në ministri kyçe, siç është Ministria e Arsimit, madje jo një person, por një departament i tërë është i nevojshëm të jetë aty për të punuar për këto çështje. Fondacioni ynë e sheh këtë si një rol kyç.

Objektivat, produktet dhe aktivitetet që janë parashikuar të financohen me përparësi për periudhën 2019-2021 në këtë grup shpenzimesh janë:

- Fonde për të mbuluar shpenzime për transportin e 28 mijë nxënësve që kanë vendbanim mbi 2 kilometër nga shkolla, si dhe transportin e 10 mijë mësuesve që punojmë mbi 5 kilometër larg nga vendbanimi, në shumën 680 milionë lekë në vit.

Ndoshta jeni familjarizuar, ose ndoshta studimi i fundit i UNICEF-it nuk ka mbërritur tek ju për gjendjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Një nga problematikat më të mëdha të këtij studimi del pamundësia e transportit si një pengesë e madhe për të aksesuar arsimin dhe shërbimet të fëmijët. Ndaj, ju lutem, parashikoni më vete një zë në buxhet për çdo gjë që ka lidhje me arsimin cilësor të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Sot do të mbahet një takim tek INSTAT-i ku do të diskutohet edhe për censusin 2020. Besoj të gjithë jemi koshientë për statistikën inekzistente ose të ngatërruara për sa u përket fëmijëve me aftësi të kufizuara, por edhe në përgjithësi, statistikën në Shqipëri janë një problem shumë i madh. Për sa kohë nuk do të vëmë në shina statistikën, nuk mund të bëjmë buxhete në ajër, është e domosdoshme të vendoset një prioritet shumë i madh. Statistikat e Ministrisë së Arsimit apo Ministrisë së Mirëqenies Sociale për grupmoshën nuk përputhen. Siç i mban njëra, nuk i mban tjetra.

Gjetje tjetër kryesore e studimit të UNICEF-it është se statistikën janë të çakorduara dhe nuk na japin një pasqyrë të pastër në të gjitha drejtimet për fëmijët në Shqipëri, sidomos për fëmijët me aftësi të kufizuara.

- Fonde për të mbuluar shpenzimet për blerjet e teksteve shkollore për rreth 190 mijë nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë, shuma e parashikuar është deri në 700 milionë lekë në vit.

- Fonde për të mbuluar shpenzimet për rishikimin e kurikulës.

E citova edhe kur fola për arsimin profesional, por gjithashtu, ju lutem, të mbajmë parasysh përshtatjen e kurikulës me një buxhet më vete edhe të pjesa e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Duhet të dini që edhe tek aksesueshmëria, ka një listë minimale të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, të cilët thonë se të paktën lista e pajisjeve teknologjike, që ndihmojnë në komunikim, të nxënë dhe në edukimin e personave me aftësi të kufizuara, duhet të jetë prezentë dhe e ndihmuar nga çdo shtet me buxhet.

Ju lutem, t'i shikojmë në përgjithësi të gjitha dokumentet që kemi dhe të mundohemi të plotësojmë kushtet për këta fëmijë, sidomos në arsim.

Kurikula është përsëri prioritet për t'u përshtatur për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara. Shumë mirë që e kemi vendosur *breil*-in, por duhet të shikojmë edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale, si e kanë të nevojshme përshtatjen e kurikulës që t'u jepen shanse të barabarta në edukim dhe arsim.

- Fonde për të mbuluar shpenzimet për veprimtarinë e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit për realizimin e funksioneve të inspektimit në arsim, 90 milionë lekë në vit.

Për t'u kthyer te shkollat speciale, Zela do të më plotësojë, besoj, kemi vërejtur se është ngritur një task-force në Ministrinë e Arsimit me organizata të shoqërisë civile, e cila ka funksionuar deri diku, por ne nuk jemi ende të kënaqur dhe mendojmë ta intensifikojmë punën bashkërisht. Një nga gjërat që vumë re ishte se asnjë nuk i inspekton shkollat speciale. Pra, këto inspektorate nuk po e bëjnë punën e tyre.

Ju i keni parë shkollat speciale dhe institucionet tona në media, nuk janë raste sporadike, por janë gjëra për t'u kontrolluar përditë dhe, gjithashtu, të kenë një buxhet më vete.

Çdo vit trajnohen 10-15% e punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar, por trajnimet e stafëve për arsimin e personave me aftësi të kufizuar, deri më tani janë mbuluar nga organizatat e shoqërisë civile. Jemi të vetëm. Në një kohë që mezi mbijetojmë për ato shërbime që kemi, marrim përsipër, sigurisht, falë projekteve që na japin donatorët, të bëjmë edhe trajnime për mësuesit. Ashtu si organizata prindërore, është në interesin tonë për të pasur një arsim cilësor më të lartë.

Ju lutem, të jemi specifikë, të matshëm, me objektiva optimale për të rritur cilësinë e arsimit në trajnimin nga lart deri poshtë, drejtoritë arsimore, drejtorë shkollash, duhet të kuptohet në të gjitha arsimi gjithëpërfshirës dhe ai i fëmijëve me aftësi të kufizuar.

Milva Ekonomi – Më falni që po ju ndërpres!

Po flasim për buxhetin e vitit 2019. Lista që ju keni vendosur është e gjithë prioriteteve. Ndërgjegjësimi për këtë çështje është i madh, por ju keni një problem të të mirëkuptuarit të kësaj çështjeje nga ata që kanë në dorë bërjen e politikave, mesa kuptoj, kjo është çështja kryesore. Si do ta shikoni ju një prioritet më të rëndësishmin për ju, i përkthyer në buxhetin e vitit 2019? Duhet të luftojmë dhe të bëjmë përpjekje për një prioritet, se lista me kaq shumë kërkesa në një buxhet të vetëm nuk vendoset dot. Është e pamundur. Por ama, duhet të luftojmë të realizojmë një gjë këtë vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk mund të jetë asnjëherë kështu si thoni ju, në një buxhet.

Ju keni bërë një listë me shumë kërkesa, janë pjesë e strategjive, e vërtetë, por ama nuk mund të jenë të tëra për buxhetin e vitit 2019! Duhet vendosur se cila është më e rëndësishmja për ju për këtë buxhet.

Besa Shahini – Atëherë, nga të gjitha këto po veçojmë vetëm një gjë, e kemi diskutuar edhe në Ministrinë e Arsimit, në lidhje me një pikë fokale, sepse atje kemi vetëm gjysmë personi që merret me aftësinë e kufizuar dhe e ka të pamundur të bëjë çështjen e arsimit gjithëpërfshirës, kur është vetëm gjysmë. Domethënë, le të vendoset një buxhet i ndarë në ministri për një apo dy persona, sa të shohë të mundur ministria, që të merret me problemet e arsimit gjithëpërfshirës dhe vitin tjetër, vijmë me prioritetet e tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po të kemi pikat fokale të forta, them që Kuvendi do të jetë më i lehtësuar.

Gjëja tjetër që do të doja të sillja në vëmendjen e komisionit është se para 3 vjetësh është miratuar buxheti i arsimit parashkollor të shkojë te bashkitë. Ky buxhet që ka shkuar te bashkitë është bërë shumë mirë në ligjin e decentralizimit. Problemi qëndron që bashkive u jepet buxheti për pagat, por, kur kërkohet që të vendosim ne mësues ndihmës në arsimin parashkollor, këtë gjë duhet ta bëjmë nëpërmjet portalit të arsimit. Pra, kemi dy ministri, domethënë bashkia thotë mund të mos kem buxhet, ndaj do t'ju lutem që këtë gjë ta vendosë Ministria e Arsimit me financat e veta. A do ta mbajë bashkia? Unë jam për atë që të zbatojmë ligjin e decentralizimit, sepse, në qoftë se do t'i ketë bashkia, komisioni multidisiplinar i ngritur i DAR-it do të bëjë një vlerësim biopsikosocial dhe fëmija me aftësi të kufizuar do të të ketë edhe shërbimet përkatëse.

Do t'ju lutesha, ta shikoni këtë si një çështje të rëndësishme. Është e rëndësishme se çfarë do të bëjmë për decentralizimin e çështjeve të arsimit. Pra, buxheti i arsimit parashkollor ose duhet t'u shkojë bashkive, ose duhet parë mundësia që ta kthejmë përsëri te Ministria e Arsimit.

Dua të përforcoj diçka në lidhje me arsimin profesional, sepse është përsëri e njëjta gjë. Ne kemi bërë disa ndryshime këto vite, mbase për të provuar edhe veten tonë, se çfarë do të ishte më mirë dhe ku do të ishte më mirë, por qendrat e trajnimit profesional janë diçka tjetër dhe shkollat e arsimit profesional janë diçka tjetër, të cilat do të presin të gjithë nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë dhe kanë aftësi të kufizuara intelektuale. Prandaj, themi se edhe ky buxhet duhet të shikohet me prioritet, ndoshta nuk mund të kthehet sivjet, se mbase ka shumë ngarkesa, por buxheti i arsimit profesional duhet t'i kalojë Ministrisë së Arsimit. Të paktën nga praktika ne nuk mund ta çojmë në një qendër arsimit profesional një person, i cili duhet të trajnohet në një qendër të trajnimit profesional, sepse këto qendra janë ndryshe. Pra, qendrat e trajnimit profesional janë për të gjithë popullatën dhe duhet t'i marrë ministria përkatëse, kurse arsimi është diçka tjetër. Këto dy gjëra kisha.

Faleminderit!

Milva Ekonomi - A dëshiron dikush tjetër të flasë?

Altea Lula - Përshëndetje!

Quhem Altea Lula, përfaqësuese e qendrës “Për arsim cilësor”. Unë do të flas shkurtimisht, pasi ne kemi dërguar edhe një material të plotë pranë komisionit. Unë u bashkëngjitem të gjitha propozimeve që thanë parafolësit për sa i përket rritjes së financimit në arsim në përgjithësi. Unë dua të fokusohem pikërisht te shërbimi psikosocial, sepse është krejtësisht e pamundur që të arrihet ofrimi efektiv i këtij shërbimi në rast se vlera do të vazhdojë të jetë e këtij lloji.

Për sa i përket numrit të mësuesve ndihmës, si një nga rezultatet e parashikuara në strategjinë për politikën, nxënia gjithëpërfshirëse dhe cilësore, ofrimi i shërbimeve riaftësuese për fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore në çdo bashki brenda vendit, nuk pasqyrohen në asnjë prej produkteve të PBA-së 2019-2021. Shërbimi riaftësues i ofruar nga institucionet publike ose në ato me financim publik rezulton i pamjaftueshëm apo mungon tërësisht në shumë prej bashkive. Në këto kushte duke konsideruar...

Milva Ekonomi - Më falni, unë e kam materialin tuaj dhe e kam lexuar, por nuk pashë atë që quhet 3E. Një shoqatë e juaja bën analiza të 3E-ve dhe ti e di shumë mirë se çfarë janë 3E-të: efienca, efektiviteti dhe ekonomiciteti. A keni bërë ju një analizë të 3E-ve të këtyre parave shtesë, që vijnë në këtë shërbim? Çfarë do të sjellin këto, sepse disa para shtesë janë te Ministria e Arsimit këtë vit? Pra, a i keni kanalizuar, si do të jenë këto 3E-të, sepse gjërat e tjera janë shumë të përgjithshme? Si e siguron ju ministrinë se këtë shtesë do ta përdorni sa më mirë? Pra, mos thoni gjëra të përgjithshme këtu. E rëndësishme është që analiza është bërë dhe juve ju është akorduar një shtesë që duhet ta përdorni.

Altea Lula – Ajo që ne kërkojmë nga komisioni është që t’i rekomandojë Ministrisë së Arsimit që mësuesi ndihmës të vendoset si produkt më vete në VBA.

Tjetër gjë ka të bëjë me shpenzimet për nxënësit, të cilat aktualisht janë 70 mijë lekë, por duhet të arrijnë në vlerën afërsisht 92 mijë lekë. Ndërkohë, ne kemi një hendek jashtëzakonisht të madh ndërmjet atyre që premtohen dhe atyre që kemi aktualisht. Ne besojmë se planifikimi dhe strategjitë, të cilat janë miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, qëndrojnë dhe marrin, sigurisht, bazë ligjore. Për këtë arsye duke e analizuar PBA-në, si i vetmi vend ku ne mund të

gjejmë produktet dhe të kontrollojmë atë çfarë ka buxheti i shtetit, ne kërkojmë vendosjen e mësuesit ndihmës si produkt më vete në PBA.

Milva Ekonomi – Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave duhet ta mbajnë shënim këtë gjë, nëse do të jetë e mundur që të bëhet.

Hazis Doçi – Të them të drejtën unë nuk kam njohuri nga financat, sepse më shumë marr vesh nga fëmijët. Në qoftë se flitet për fëmijët me aftësi të kufizuara, në radhë të parë, Ministria e Arsimit duhet të marrë një risk më të madh se buxhetimi. Ajo duhet të ngrejë një strategji kombëtare për edukimin në vazhdim si model. Nëse ne u referohemi komisioneve të DAR-it, pothuajse 80% e tyre e marrin rrogën kot ose, më saktë, të gjitha vlerësimet janë subjektive. A ka mundësi që Ministria e Arsimit të krijojë një filozofi ndërtimi, duke filluar që nga departamentet kërkimore në fushën e aftësisë së kufizuar dhe shërbimit cilësor dhe ta shtrijë deri te DAR-i e poshtë në kopshte, që këtë cilësi produkti ata që do ta marrin, ta marrin siç duhet? Për mua kërkesa për buxhet më vete duhet të ketë departament kërkimi në Ministrinë e Arsimit, që të krijojë një strategji më vete në edukimin gjithëpërfshirës. Pra, të jetë si produkt më vete, një zë më vete, një buxhet për kërkimin e arsimit cilësor për këta fëmijë. Në qoftë se ti nuk ke një departament kërkimor, si mund t'i kërkohet një mësuesi ndihmës, një mjeku të DAR-it cilësinë e produktit? Këtë gjë nuk e bën dot. Në qoftë se ti ke një komision me specialistë të fushës, që ata të japin rekomandime për gjithë këto gjëra, atëherë do të jetë shumë e thjeshtë dhe më e lehtë për fëmijët në të gjithë Shqipërinë. Pra, unë kërkoj që të ketë një departament kërkimor në fushën e arsimit dhe besoj se kjo është e domosdoshme.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

A mund të na japin disa sugjerime përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit?

Po, zonja Zajmi.

Emanuela Zajmi – Faleminderit!

Pa dyshim, ajo që tha zonja Zela është thelbësore. Ne e dimë se nuk jemi një vend i pasur, por nuk jemi as vend i varfër për të vënë një buxhet vetëm për këtë gjë. Unë mendoj se çdo gjë duhet të ketë një zë më vete për aftësinë e kufizuar. Për mendimin tim është shumë e rëndësishme që të bëhen matje vit pas viti se si ne po ecim me këtë gjë. Kështu që ajo që tha zonja Zela qëndron, por unë mendoj se duhet të jemi më konkretë në një zë vetëm për arsimin gjithëpërfshirës.

Besa Shahini – Faleminderit!

Gjithashtu, falënderoj edhe shoqatat, me të cilat kemi një bashkëpunim të shkëlqyer!

Një pjesë e madhe e pjesëmarrësve që ndodhen këtu bëjnë pjesë edhe në grupin e punës brenda Ministrisë së Arsimit, të cilët po merren me aftësinë e kufizuar. Unë do të flas shkurt dhe po adresoj vetëm disa nga gjërat që u ngritën këtu, ndërsa pjesën tjetër mendoj se do ta shtojë zoti Florian.

Strategjia për arsimin parauniversitar do të mbyllet në vitin 2020, por ne kemi në plan që të ndërtojmë një strategji të re, e cila nuk do të jetë vetëm për arsimin parauniversitar, pra do të mbulojë parashkollorin dhe deri te arsimi i lartë, në mënyrë që t'i ndjekim hallkat nga fillimi deri në fund që edhe për arsimin gjithëpërfshirës mund t'i ndjekim nxënësit nga fillimi deri në fund. Besoj se ky është një lajm i mirë, sepse do të kemi mundësi që të bëjmë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme në sistem, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, që ka arsimin profesional, me bashkitë që kanë arsimin parashkollor, si dhe me Ministrinë e Shëndetësisë, që merret me aspektin e asistencës sociale e të tjerë.

Shkolla si qendër komunitare

Mënyra se si funksionon sistemi i arsimit është e atillë që ne menaxhojmë pjesën çfarë ndodh brenda në shkollë, pra me përmbajtjen mësues, ndërsa bashkitë menaxhojnë pjesën e infrastrukturës. Shkolla si qendër komunitare në këtë formë organizohet që ne u paguajmë mësuesve orët shtesë, në mënyrë që të rinjtë të organizojnë aktivitetet jashtëshkollore, ndërsa bashkitë kryesisht mundësojnë aktivitet e tjera, që kanë të bëjnë me pjesën e përdorimit të palestrës apo gjithçka tjetër që organizohet në nivel shkolle.

Milva Ekonomi – A kanë ndonjë rol komitetet e prindërve në këto shkolla komunitare?

Besa Shahini – Qëllimi i shkollës si qendër komunitare është që të sjellë të gjithë komunitetin, duke përfshirë edhe prindërit brenda shkollës. Shpesh komiteti i prindërve angazhohet edhe në mbledhjen e fondeve të ndryshme për të organizuar ndonjë aktivitet, por që të jenë edhe pranë nxënësve gjatë aktiviteteve që ata kryejnë pasditeve. Në bashki të ndryshme kjo funksionon në forma të ndryshme, varësisht edhe nga iniciativat që marrin bashkitë.

Zonja Emanuela ka të drejtë kur thotë se nuk ka një mënyrë se si kjo gjë funksionon në të gjithë Shqipërinë. Ajo që ne sigurojmë për secilën shkollë është numri prej 10 orëve shtesë të mësimi, që ne u paguajmë mësuesve, në mënyrë që orët të jenë të ndara për aktivitetet e pasdites. Ne jemi duke bërë përpjekje të vazhdueshme me organizatat e shoqërisë civile, si dhe me të gjithë anëtarët që marrin pjesë në këto shkolla qendra komunitare, në mënyrë që të organizojnë sa më shumë aktivitete pasdite. Natyrisht, bashkitë, që janë më mirë nga ana financiare, bëjnë më shumë

se sa bashkitë e tjera. Gjithashtu, ne po mundohemi që t'u japim të gjithëve një udhëzues që të mund të organizojnë aktivitete të ngjashme si në Bashkinë e Tiranës dhe në bashkitë e tjera.

Për sa i përket cilësisë së arsimit Shqipëria, nuk mbetet mbrapa vendeve me të ardhura të ngjashme. Në fakt, studimi i Bankës Botërore, duke parë rezultatet e testit “PISA 2015”, thotë se Shqipëria mban vendin e parë në krahasim me vendet me të ardhura të njëjta për sa i përket cilësisë së arsimit.

Së dyti, diçka tjetër interesante është edhe dallimi i rezultateve të arritura midis djemve dhe vajzave, ku vajzat kanë marrë njohuri dhe dituri në vlerën e 2,5 vjetëve shkollimi më shumë se sa djemtë. Pra, bashkë me organizatat e shoqërisë civile ne kemi bërë diçka të mirë, ku e kemi vendosur fokusin te vajzat, por tani duhet t'u japim pak përqendrim edhe djemve, të cilët duket se kanë mbetur pak mbrapa. Sidoqoftë, edhe pse jemi në këtë pikë, krahasuar me vendet që kanë të njëjtin zhvillim ekonomik, ne mendojmë se duhet të arrijmë më shumë. Kështu, ne kemi bërë përpjekje të vazhdueshme edhe me ndryshimet kurrikulare, me librat falas e të tjerë. Unë shpresoj që këto të reflektohen tek testi “PISA 2018”.

Lidhur me sektorin e posaçëm, që është brenda Ministrisë së Arsimit, për komunitetin egjiptian, për komunitetin rom, si dhe për aftësinë e kufizuar, ne në parim jemi dakord dhe kemi bërë përpjekjet tona, por duke qenë se është bërë riorganizimi administrativ, ku ministrinë në njëfarë mënyre janë të ndara në strategji, politika dhe projekte, është e pamundur që të kemi grupacione tematike. Ne shpresojmë që ta bëjmë, por duke qenë se riorganizimi po vazhdon edhe tek institucionet e varësisë, shpresojmë që do të mund ta bëjmë në njërin nga institucionet e varësisë, i cili do të ketë rolin për të zbatuar politikat që merren në nivel të ministrisë.

Lidhur me trajnimin e mësuesve ndihmës, për momentin jemi duke bërë auditim të të gjitha trajnimeve që kanë ndodhur vitin e fundit (sepse është bërë një proces i riakreditimit të të gjitha trajnimeve që kanë ndodhur në të kaluarën), në mënyrë që të mund të shikojmë nëse mësuesit marrin trajnimin e nevojshëm, shkojnë në orët e mësimi, ashtu sikurse është e nevojshme që ata të jenë prezentë, dhe cilat janë rezultatet e këtyre trajnimeve. Shpresoj që shumë shpejt do të hapim edhe thirrjen për akreditimin e trajnimeve të tjera shtesë dhe kjo do të ndihmojë në përmirësimin e shërbimit që mësuesi ndihmës të japë në nivel klase. Ne kemi biseduar edhe me organizatat e shoqërisë civile, sepse nuk është ideja që ne të trajnojmë vetëm mësues ndihmës, por gjithsesi duhet që edhe mësuesi i klasës të jetë mirëinformuar për aftësinë e kufizuar dhe për mënyrën se si mund të ndihmojë që nxënësi me aftësi të kufizuara të arrijë potencialin e vet maksimal brenda

sistemit të arsimit. Ndoshta vlen të përmend se gjithëpërfshirja nuk ka të bëjë vetëm me përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara apo me përfshirjen e nxënësve që vijnë nga komunitete minoritare, por ka të bëjë me nxënës që jetojnë në zona të thella rurale, të cilët shkojnë në shkolla të izoluara nga komuniteti tjetër arsimor.

Ne sivjet jemi munduar që të zbrisim numrin e nxënësve që mësojnë në klasa kolektive dhe t'i transferojnë ata në shkollat më të afërta, të cilët mund të socializohen. Ne kemi arritur që 3 mijë nxënës, nga 33 mijë sa kanë qenë vitin e kaluar në klasa kolektive, të transferohen në shkolla të tjera të mëdha dhe kjo do të vazhdojë edhe në vijim. Pra, tek elementi i strategjisë, që merret me gjithëpërfshirjen, ne do të vazhdojmë të shtyjmë para edhe politikën e adresimit të nxënësve në klasa kolektive, që nuk do të thotë vetëm transferimin e tyre në shkolla më të mëdha, por që edhe mësuesit të marrin më shumë përkrahje dhe më shumë burime të tjera, në mënyrë që të mund të zhvillojnë sa më mirë orët mësimore në klasat e tyre.

Unë do të ndalem këtu, sepse besoj se edhe zoti Florian ka diçka për të shtuar.

Milva Ekonomi – A ka një person të dedikuar, që të merret me aftësinë e kufizuar, në mënyrë që ky person të kërkojë gjërat e nevojshme të përditshme?

Besa Shahini - Mënyra se si e kemi zgjidhur është se ekziston një pikë kontakti brenda ministrisë, që gjithmonë është në kontakt me shoqatat dhe me organizatat e tjera.

Milva Ekonomi – Pika e kontaktit është një gjë, kurse ata kërkojnë një person të dedikuar me dije për këtë punë.

Besa Shahini - E para është pika e kontaktit dhe e dyta është grupi i punës, ku unë jam plotësisht e përfshirë dhe po mundohem që të shlyej maksimalisht të gjitha kërkesat, në mënyrë që realizohen me politika dhe me buxhete, por edhe me praktika në shkolla.

Për sa i përket personit të dedikuar, që ka përshkrim pune kjo për momentin nuk është e mundur, sepse riorganizimi administrativ që ka ndodhur tani vonë e ka mbyllur mënyrën se si organizohet një ministri brenda saj, duke i ndarë këto tri departamente, siç thashë: strategjitë, politikat dhe projektet. Ne po mundohemi ta zgjidhim në këtë formë, duke krijuar grupe pune, të cilat janë të dedikuara për çështje të aftësisë së kufizuar, por nuk është e mundur që të realizohet kjo gjë që po kërkohet për momentin.

Milva Ekonomi – Ne do të bëjmë diçka: së bashku do të hartojmë një kërkesë me shkrim për Ministrinë e Arsimit. Komisioni këtë gjë ka mundësi ta bëjë dhe, më pas, ju mund ta shikoni, sepse nuk është kjo dëgjesa e parë që ne po bëjmë, por kemi bërë disa herë dëgjesa për këtë çështje.

Unë besoj se këtë mund ta zgjidhim, duke ju bërë juve një kërkesë me shkrim nga komisioni dhe ju mund të shikoni mundësinë me prioritet për të organizuar këtë lloj shërbimi.

Këtu kemi dy përfaqësues: njëri nga Ministria e Arsimit dhe tjetri nga Ministria e Financave, të cilët po kërkojnë fjalën, zotin Florian dhe zotin Genti.

Florian Nurçe – Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve!

Falënderoj përfaqësuesit e shoqërisë civile, të cilët këtë vit i kemi thirrur në dy takime të gjata dhe i kemi dëgjuar për çdo sugjerim, për çdo kërkesë, duke kemi marrë parasysh se çfarë kërkon shoqëria civile, aq sa neve na lejon buxheti, lidhur me mundësitë financiare, mundësitë e burimeve njerëzore për t'i reflektuar në buxhetin e vitit 2019-2021!

Dua të sqaroj diçka lidhur me buxhetin, sepse unë kam folur edhe javën e kaluar, komisioni ka marrë sqarime lidhur me bursat për statistikët.

Financimi që tregohet në relacionin e buxhetit është 2,2%, por, në fakt, financimi që shkon për arsimin është 3,3%. Tabelat dhe relacionet unë ia kam kaluar shoqërisë civile para datës 25 tetor me të gjithë standardin maksimal, që në kompetencën tonë profesionale dhe ligjore, ne i hartojmë dhe ia dërgojmë titullarëve, të cilët i kanë të gjithë treguesit se ku dhe si arrin buxheti në 3,3%

Lidhur me numrin e punonjësve psikosocialë apo me numrin e punonjësve ndihmës mësimor në arsimin parauniversitar, dua të them se deri në datën 25 tetor unë konfirmoj se janë më shumë se 600 punonjës psikosocialë në shkollën në arsimin parauniversitar dhe më shumë se 70 persona janë punësuar sipas standardeve si ndihmës mësimorë. A ka pagesa, ishte një pyetje, për punonjësit...

Milva Ekonomi – Më falni, se këtu ka një gjë. Kur ju i mësoni dhe bëni kontratën të përshkrimi i punës, a i merrni në konsideratë opinionet që sjellin shoqatat, se si ky punonjës duhet të kryejë aktivitetin e përditshëm, pra si duhet ta zhvillojë ai procesin e punës?

Florian Nurçe – Patjetër!

Kjo gjë bëhet që në shpalljen për të marrë punonjës si ndihmës mësimor, të cilët duhet të kenë kompetenca profesionale shumë më të gjera se sa një punonjës apo një mësues fizike, kimie, biologjie, gjuhe apo historie. Ky mësues duhet të ketë edhe specializime apo trajnime të tjera të veçanta që plotëson këtë kusht. Kjo ka qenë një nga pengesat, ndoshta më ndihmon zëvendësministrja, që nuk është plotësuar menjëherë, sepse mund të ketë vende bosh në Shkodër,

në Korçë apo në Tiranë apo shoqata që mund të plotësojnë këto vende vakante për mësuesin ndihmës, por nuk ka njerëz me kompetenca profesionale për t'i plotësuar këto vende. Gjithashtu, edhe shkollat apo universitetet tona nuk prodhojnë mësues të specializuar për këtë qëllim. Ka pasur një departament në Universitetin e Vlorës që ka lëshuar diploma të tilla, por numri i tyre është i kufizuar, madje zonja deputete, që është këtu, e cila ka qenë pedagoge në Universitetin e Vlorës, mund ta konfirmojë këtë gjë.

Milva Ekonomi – A mund të drejtoheni për të bërë disa TOT-e me ndihmën e donatorëve, sepse në qoftë se nuk ka, atëherë duhen bërë, apo jo!?

Florian Nurçe – Unë përgjigjem për buxhetin, por megjithatë di se Instituti i Zhvillimit të Arsimit ka ndërtuar kurrikula trajtimi për vitin 2019-2021 dhe përfshirja e tyre në trajnime me fonde buxhetore apo përfshirja në trajnime me fonde të donatorëve mund të bëjë që këta punonjës, tashmë të punësuar, të rrisin kapacitetin e tyre profesional, por edhe të rinj të tjerë që janë punëkërkuar të marrin trajnime dhe të bëhen konkurrentë për këta që janë në sistem apo për nevojat që do të ketë sistemi arsimor.

Besa Shahini – Më falni, dua të bëj vetëm një shtesë të vogël.

Pra, ne kemi numrin e mësuesve ndihmës që janë në sistem dhe që kanë nevojë për trajnime shtesë, mësues të zakonshëm, të cilët do të marrin trajnime në mënyrë që të adresojnë sa më mirë nxënësin me nevoja të veçanta që kanë në klasë dhe në nivele të ndryshme. Gjithashtu, universitetet kanë krijuar degë, të cilat përgatisin mësues ndihmës për të ardhmen, por kjo do të vërehet pas disa vjetësh. Pra, ne kemi 3 mënyra të intervenimit për të adresuar këtë çështje.

Florian Nurçe – Përfaqësuesi i shoqatës së egjiptianëve sqaroi se në universitete ka pasur kuota për studentët pa kushtin meritë preferencë. Këta janë të vetëdijshëm se ka pasur kuota rreth 20 apo 25 në vit.

Sivjet, me miratimin e ligjit për pakicat kombëtare, ministria ka hartuar dhe ka miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave që pakicat kombëtare do të kenë një preferencë tjetër, e cila automatikisht i ndihmon ata të regjistrohen që të ndjekin edhe ciklin master dhe të gjitha nivelet e studimit në universitete. Gjithashtu, i ndihmon që këto studime ata t'i kryejnë falas, pa tarifë, si dhe në arsimin profesional. Në seancën e kaluar unë kam shtjelluar që në vendimin e Këshillit të Ministrave për arsimin profesional të gjithë romët dhe egjiptianët të marrin bursë, pavarësisht se shtëpia dhe shkolla e tyre janë ngjitur apo shkolla profesionale është brenda qytetit si qendër urbane. Pra, ata marrin bursë, ndjekin studimet falas, marrin libra falas, por marrin edhe veshje.

Kjo vlen gjithashtu edhe për ata që ndjekin arsimin profesional. Bursa që ata marrin nuk është pak për atë që kemi ne me financat tona publike, me atë jep njësia e qeverisjes vendore për ndihmën ekonomike apo sociale. Krahësuar bursa e një nxënësi është 660 lekë në muaj, kurse bursa e një studenti është 8900 lekë në muaj dhe për 8,5 apo 9 muaj ka një kosto financiare. Po ashtu, veshja, kuota ushqimore dhe të drejta të tjera u janë përjashtuar nga tarifat e shkollimit në universitete apo janë përjashtuar nga çdo tarifë tjetër që zbatohet në universitetet tona publike. Librat falas nuk ka ndonjë ankesë, se 190 mijë fëmijë i kanë marrë librat falas. Fondi i dedikuar ka qenë 6,2 dhe po shkon në 7 milionë dollarë dhe nuk ka asnjë fëmijë që mund të ankohet. Cilido që ka ankesa ne mund t'ia zgjidhim brenda ditës dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore apo financiare.

Zonja Zajmi, financimi për institucionet tona speciale për fëmijët me aftësi të kufizuara është gati 20 herë më i shtrenjtë se financimi që ndodh për të gjithë fëmijët e tjerë.

Pajisja me tekste të gjuhës brail apo trajtimi, ushqimi dhe kujdesi për fëmijët në këto institucione për 24 orë është shumë i kushtueshëm. Në të gjitha këto shkolla, që ne i quajmë speciale, të cilat janë në Shkodër, Durrës, Korçë, Vlorë, Elbasan, Tiranë e të tjera, nuk ka asnjë pengesë ligjore, udhëzime të zakonshme apo urdhër të ministrit që pengon fëmijët me aftësi të kufizuara të shkollohen. Ka pasur një pengesë për transportin, por që nga korriku i vitit 2015 ne kemi hequr çdo pengesë dhe familjet e tyre të përfitojnë nga fondet publike për transportin e fëmijëve në shkollë.

Emanuela Zaimi – Ju po thoni që shkollat speciale janë shkolla perfekte dhe fëmijët duhet të vazhdojnë të shkojnë në shkolla speciale?

Florian Nurçe – Jo, perfekte nuk e thotë njeri.

Emanuela Zaimi – Ne nuk duhet të kemi më shkolla speciale, ne jemi kundër atij parimi...

Besa Shahini – Emanuela, ne e kemi diskutuar disa herë që shkollat speciale janë në proces të shndërrimit të tyre në shkolla burimore, ndërsa Flori po përgjigjet për pjesën e buxhetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Flori merret me pjesën e buxhetit.

Florian Nurçe – Për ta kthyer këtë shkollë në qendër burimore, buxheti i arsimit duhet të rialokohet dhe t'i shikojë me përparësi nxënësit me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, edhe shoqëria duhet të kujdeset maksimalisht. Pra, nuk ka asnjë pengesë ligjore që ata fëmijë të financohen me çfarë u nevojitet për t'i edukuar në institucione speciale apo të veçanta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka diçka që buxhetin nuk e gjejnë të argumentuar me statistika dhe nuk e gjejnë të veshur me produkte. Nëse buxheti i arsimit nuk ka statistika, nuk e di se si mund të bëhet. Buxheti është i miratuar nga titullarët dhe gjendet në faqen elektronike. Në çdo program ka buxhet dhe tregues statistikor, pra mund të ketë 10 deri 20 tregues statistikorë, ku tregohet se çfarë bëhet me menaxhimin e arsimit bazë, e arsimin e mesëm, e arsimin e lartë, me kërkimin, me sportin dhe me rininë. Unë nuk besoj se statistikat mungojnë në Ministrinë e Arsimit. Ne mund të kemi statistika edhe për 20 vjet.

Milva Ekonomi – Ajo ishte për personat me aftësi të kufizuar që nuk kanë ndjekje statistikorë, kjo është çështje tjetër, nuk ka lidhje me Ministrinë e Arsimit.

Rivelino Çuno – Lidhur me çështjen e bursave të komunitetit, ne e dimë që ka një VKM, por pengesa më e madhe për studentët janë bursat për mastera dhe nga kjo pengesë që nga viti 2016 dhe deri më sot është vërejtur një rënie e madhe e numrit të studentëve.

Milva Ekonomi – Mbase nuk keni qenë vetëm ju që keni përfituar nga kuotat, sepse ky ishte problemi i bursave tuaja. Mos harro që nga kuotat tuaja përfitonin njerëz që nuk u takonte ajo bursë, pra bursa duhet të shkojë vetëm për komunitetin egjiptian. Kjo është çështja më e rëndësishme.

Rivelino Çuno – Ne kemi rënë dakord që të identifikohen njerëzit dhe çdo student që paraqitet nga komuniteti të përjashtohet nga tarifat, por sot po shikojmë që asnjë student nuk po përjashtohet. Unë personalisht kam shoqëruar studentë nëpër shkolla për të mësuar përse nuk përjashtohen nga tarifat dhe më kanë thënë që nuk ka VKM përjashtimi për nivelin e dytë të arsimit, që është masteri. Kjo na bën ne të ngremë zërin që të rivendoset VKM-ja për përjashtimin e tarifave për nivelin master. Kjo vlen edhe për çështjen e punësimit, sepse, nëse një nëpunës nuk ka master, automatikisht nuk mundet të përfitojë punësimin dhe kjo na çon në nivelin zero.

Ne kemi punuar shumë për integrimin e këtij komuniteti deri më sot dhe kemi një raport që në vitin 2014 deri në vitin 2015 janë regjistruar 1200 studentë të kualifikuar si asnjëherë tjetër në 28 vjet, ndërsa sot kemi problemin që ky komunitet po redukton numrin e studentëve në shkollat e larta. Arsyeja është që ky komunitet nuk mundet të vazhdojë për shkak të financimeve dhe mundësive për të vazhduar një master, por edhe baçelor. Në universitetet përkatëse ka ende burokraci dhe studentët e komunitetit nuk përjashtohen nga tarifa dhe një ndër to është Universiteti i Arteve. Ju e dini shumë mirë që ky komunitet ka shumë talente dhe për këtë arsye kam takuar

personalisht rektorin edhe dekanin e universitetit, të cilët më kanë thënë që nuk është i mundur përjashtimi për një numër të tillë. Unë mendoj që duhet të parashikohet dhe të përcaktohet buxheti për këta studentë, të cilët kanë talent dhe janë të lindur për atë zana. Ndërkohë, janari dhe shkurti janë sërish muajt për përjashtimin e tarifave universitare, ne përsëri hasim në probleme me sekretariatet, sepse nuk i marrin parasysh studentët. Ne, përtej vetëdeklarimit për shkak se kryetari i shoqatës mund të mos jetë një jurist i mirëfilltë dhe nuk e njeh ligjin dhe mund të ketë një shkelje ...

Milva Ekonomi – Dua të them këtë gjë, që ta kuptojmë problemin, të na shkruani një letër neve, si komision, me kërkesat specifike që keni, pra që studentët e Akademisë së Arteve nuk përfitojnë dot bursa në momentin që ata janë në fashën e studimit, dhe ne marrim përsipër ta kalojmë në ministri. Por edhe ministria nuk del dot jashtë kornizës ligjore që ka, sepse është miratuar një VKM dhe ajo punon sipas saj, por mund të ketë përjashtime; nëse nuk ka, atëherë nuk kanë se çfarë të bëjnë. Për këtë gjë duhet të merret një nismë ligjore.

Rivelino Çuno – Ne kemi bashkëpunuar me një frymë shumë pozitive për këtë gjë, por dy vjetët e fundit na kanë vendosur në një vështirësi shumë të madhe. Për shembull, vëllai im mbaron universitetin baçelor, por nuk ka një master dhe nuk punësohet dot, pavarësisht se është mjaft i përgatitur. Kjo e bën atë një shembull negativ, sepse nuk e bën integruar në familje dhe në shoqëri. Kjo kohë, kjo sakrificë dhe ky mund që i dedikohet shkollës, duket sikur është harxhuar kot. Ju po i shikoni vetë që lënë shkollat dhe merren me punë, që nuk mund të integrohen në shoqëri. Kjo mua më shqetëson.

Milva Ekonomi – Vetëm në administratë publike mund të punosh me master, sepse të tjerët e kërkojnë me baçelor.

Rivelino Çuno – Tani është zgjeruar dhe puthitur aq mire, sa në çdo vend kërkohet masteri.

Faleminderit!

Florian Nurçe – Për pyetjen, a ka vendim për bursat dhe a ka vendim për përjashtimet e studentëve nga tarifat e studimit, dua të them që ka dy vendime të Këshillit të Ministrave, që përcaktojnë standardet dhe kriteret sesi studentët e ciklit të parë dhe programet e integruara mund të marrin bursa, ku komuniteti rom dhe ai egjiptian kanë përparësi.

Njëkohësisht ka edhe një vendim tjetër ku përcaktohen kriteret sesi përjashtohen nga tarifat e shkollimit. Këshilli i Ministrave, sipas ligjit të ri të arsimit të lartë, nuk ka të drejtë të

përcaktojë tarifa apo të përjashtojë raste me vendim qeverie në sistemin e arsimit të lartë publik, master dhe doktoraturë. Autonomia ka përcaktuar që këtë vendim e marrin bordet e administrimit në universitete.

Milva Ekonomi – Ju mund të bëni një hap për përmirësim ligjor, duke filluar me një kërkesë këtu tek ne dhe pastaj të shikojmë se si do ta përcjellë Këshilli i Ministrave vendimin. Kjo çështje tashmë është e kornizuar dhe nuk del dot jashtë saj.

Po, Emanuela.

Emanuela Zaimi – Ka një kontingjent studentësh që kanë mbaruar baçelor psikologji dhe master pedagogji speciale, gjithsej janë rreth 150 studentë. Ata nuk i pranon ministria si mësues dhe as urdhri i psikologut nuk u jepet. Ky është një kontingjent që unë nuk e di se si, por duhet të merren disa masa që këtë kontingjent ta sjellim në institucione arsimore, sepse është profili ideal për të qenë mësues ndihmës. Ata ndihen të penalizuar që kanë bërë këto dy profile, që në atë kohë e kanë promovuar dhe ua kanë kërkuar që ta bëjnë kështu, sepse do të bëhen mësues ndihmës, ndërsa sot ata janë jashtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besa Shahini – Ne jemi te kornizimi ligjor ku mësuesi ndihmës duhet të jetë mësues. Është e vërtetë që ka pak vështirësi të integrohen këta njerëz që nuk kanë kryer shkollën për mësuesi, prandaj kjo do të shikohet në të ardhmen.

Milva Ekonomi – Unë i falënderoj të gjitha shoqatat. Ne i kemi marrë shënim të gjitha shqetësimet tuaja. Së bashku do të hartojmë një letër me shqetësimet e prindërve, që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar dhe që kanë nevojë për mbështetje. Gjithashtu, komuniteti egjiptian do të na dërgojë një letër që ta fillojmë procesin, ndërsa për ministrinë, nuk kam ndonjë këshillë specifike përveçse të qëndrojmë me ne në diskutimin nen për nen.

Faleminderit shumë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fadil, të respektoj shumë dhe e kuptoj atë që ti provon.

Fadil Nasufi – Problemi është tamam për këtë çështje që ju diskutuat, për sensibilitetin e kësaj kategorie. Ata e pohuan vetë që kanë marrë takime me të gjithë stafin e ministrisë dhe janë konsultuar për buxhetin, dhe vijnë këtu e prezantojnë pa kufi strategjitë, kërkesat për organizime strukturore, kërkesat për çështje të burimeve njerëzore dhe hedhin edhe ndonjë tym, duke thënë 2.2%. Por ne duhet t'i kthejmë përgjigje për financimin në arsim.

Flori ndërhyri dhe dha komentet me një statistikë të saktë, ku tha që shkon 3.3%. Ne vijmë edhe nga komisione të tjera dhe ato janë shumë racionalë. Ata vijnë këtu për çështje buxheti, pra ata duhet të adresojnë kërkesa specifike dhe të mos i dëgjojmë pa fund.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord! Ne duhet t'u themi se sa buxhet shkon për qendrat sociale, për fëmijët, për kopshtet, për edukatoren, për personat me aftësi të kufizuar, për qendrën e shërbimeve arsimore dhe për trajnimet, prandaj duhet t'u kthejmë ndonjë përgjigje, sepse hedhin tym në media dhe na nxjerrin të tjera gjëra.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe unë atë thashë, që Flori është shumë i strukturuar në përgjigjet që jep.

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.11.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Diskutimi dhe votimi nen per nen dhe në tërësi i projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2019” (*komision për dhënie mendimi*).

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Vilma Bello, Fidel Ylli, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Musa Ulqini, Besnik Baraj (zëvendësues), Anduel Xhindi (zëvendësues).

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Sezai Rrokaj.

Të ftuar:

Besa Shahini - zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Florian Nurçe - përgjegjës në Sektorin e Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë,

Shpëtim Shehu – drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Kulturës,

Eridana Zoto - përgjegjëse në Sektorin e Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Kulturës,

Gentian Opre – drejtor i Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,

Ina Dhaskali – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Në diskutimin për projektligjin “Për buxhetin e vitin 2019” nuk është se kemi shumë gjëra të ndryshme nga ato që kemi diskutuar; kemi për të diskutuar diçka vetëm për ligjin për TVSH-në. Ne e kemi lexuar projektbuxhetin.

Fillojmë diskutimin nen për nen të projektligjit, por problemi është se ne nuk bëjmë dot ndryshime te nenet, sepse këto ndryshime i bën Komisioni i Ekonomisë. Ne e çuam raportin e diskutimit në parim te Komisioni i Ekonomisë, ku ramë dakord për të bërë disa shtesa për RTSH-në, për Akademinë e Shkencave, për QKK-në, për rregullime legjislative dhe investime te Qendra Shqiptare e Albanologjisë, te ATSH-ja dhe te sporti. Këto shtesa ia kemi çuar si paketë. Ministria e Arsimit, Ministria e Kulturës dhe Arsimi Profesional nuk paraqitën shtesa, ndërsa Akademia e Shkencave paraqiti një shtesë, ku nga 2 milionë ne i miratuam 1 milion; RTSH-ja kërkoi një shumë, e cila u konfirmua edhe nga Komisioni i Ekonomisë; QKK-së i miratuam shtesën për festivalin kombëtar; ATSH-së i miratuam shtesën për investime kapitale që i duhej dhe Sportit, sipas miratimeve që janë bërë paraprakisht lidhur me aktivitetet që duhet të kryejë vitin që vjen. Ne nuk mund ta lëvizim nenin 1, sepse këtë shkresë ia kemi çuar komisionit të Ekonomisë, i cili do të marrë vendimin ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, do të ketë rialokime dhe kjo është një gjë që e rregullojnë ata.

Neni 1, a jeni dakord ta miratojmë me ndryshimet që kemi çuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fadil Nasufi – Kisha një diskutim.

Milva Ekonomi – Po patjetër.

Ismet Beqiraj – Ne kemi rënë dakord me shtesat, por kemi lënë edhe një klauzolë të hapur. Gjatë diskutimit dhe dëgjësës me përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit dhe të Financës e Ekonomisë, unë kam bërë dy propozime konkrete dhe po i ribëj përsëri. Ne kemi çuar propozimet në terma financiarë, por duhen bërë edhe dy propozime kur të kalojë edhe te komisioni përgjegjës. Në objektivat e qeverisë shqiptare është mbështetja e arsimit dhe formimit profesional, që kur mori mandatin u tha: “Në çdo bashki të ngrihet një shkollë profesionale”.

Milva Ekonomi – Jo, në program nuk është shkollë, por një qendër e arsimit profesional.

Ismet Beqiraj – Dakord, qendër e arsimit profesional. Unë kam kërkuar që në zonën e Mallakastrës të qytetit të Ballshit në shkollat e reja që do të ndërtohen, të shtohet edhe një shkollë për sektorin e industrisë së nxjerrjes, prodhimit dhe përpunimit të naftës, që diktohet nga miratimi i dhënies së statusit të naftëtarëve.

E dyta, kur janë bërë ndryshimet përkatëse të ligjit për arsimin parauniversitar, duhet parë edhe mbështetja për transportin e nxënësve dhe mësuesve. Të shtohet ose të korrigjohen tarifat e transportit, që të mos kujtohem kur të fillojë viti i ri shkollor.

Milva Ekonomi – Dakord, do ta shënojmë.

Fidel Ylli – Unë e kam një kërkesë, pavarësisht vërejtjeve që gjithmonë kam për sportin në çdo buxhet, sepse ato çdo vit pothuajse janë njëlloj. Pra, po flas për buxhetin që është një zë për grantin e 25 federatave sportive.

Me ligjin e kompanive të basteve dhe kompanive sportive, pra në mënyrë ligjore sporti merrte 0.4% të fitimit të tyre. Në ligjin e kompanive të basteve thuhet: “çdo muaj kompanitë e basteve derdhin në numrin e llogarisë së ministrisë përgjegjëse për sportin 0.4% të shumës së tyre”. Prandaj ne kërkojmë këtë kompensim me 25 milionë lekë të rinj, t’i shtohet buxhetit të sportit. Kam biseduar me Kryeministrin dhe më ka thënë që këtë memo t’ia dërgoja kryetarit të grupit, ministrit të Financave, kryetarit të komisionit dhe unë ua kam çuar të gjithëve me *e-mail*. Prandaj do t’ju lutesha ta shikoni me përparësi, sepse është kompensim. Pra, buxheti i sportit është parashikuar në këtë shumë, duke pasur edhe 25 milionë lekë që vinin nga ligji për kompanitë e basteve, ata tani do të mbyllen dhe ne e kemi gropë në buxhet. Pra, kjo është domosdoshmëri.

Po flas për sportin elitare, për kampionë ”Botë dhe Europë”, të cilët presin të marrin shpërblimet, sepse ministria nuk ka fonde, nuk ka buxhet.

Milva Ekonomi – Kemi edhe këto dy kërkesa që duhet t’i vendosim te pjesa e buxhetit që do t’ia dërgojmë Komisionit të Ekonomisë.

Tani fillojmë..

(Diskutime pa mikrofon.)

Florian Nurçe – Kam një sugjerim për të shtuar.

(Diskutime pa mikrofon.)

Zonja Milva,..

(Diskutime pa mikrofon.)

Në mbledhjen e kaluar ju kam kujtue që ka një vendim të Këshillit të Ministrave që duhet ta transferojmë buxhetin, pasi ndodhet ende, sipas relacionit, në buxhetin e Ministrisë së Arsimit. Me vendim të Këshillit të Ministrave, dy klube sportive janë transferuar te Bashkia e Tiranës, kështu që në letrën zyrtare që i kemi dërguar me firmë të ministrit i kemi kërkuar Ministrisë së Financave që të pakësojë 26 punonjës, si dhe fondin e tyre prej 32 milionë lekësh. Ky fond duhet të largohet nga ne pasi në janar të vitit 2019 ne nuk mund ta kemi në buxhetin e arsimit pasi Këshilli i Ministrave ka vendosur të transferohet.

(Diskutime pa mikrofon.)

Dakord.

(Diskutime pa mikrofon.)

Dakord. Faleminderit!

Fadil Nasufi - ... Ministrisë së Financave. Për sa i përket transfertës së pakushtëzuar, që i ndahet qeverisjes vendore, ajo ka një formulë të gjithëpranuar, që lidhet me popullsinë relative, me dendësinë e popullsisë, me numrin faktik të nxënësve në shkollë, me transfertën specifike që këtë vit kalon në transfertë të pakushtëzuar dhe me kriterin e vështirësive të zonave malore, që kanë një koeficient 1-4. Ky klasifikim u ka ngelur që para viteve '90. Ja ku është Fideli. Futen Skrapari, rrethinat malore të Beratit, mali i Tomorit është 2417 metra, zona e Qafë-Dardhës dhe zona e Tërpanit me koeficient favorizues dhe privohet nga e drejta e përfitimit të këtij koeficienti. Unë nuk e di ku referoheni dhe e merrni këtë kriter, që të mos merret parasysh koeficienti i vështirësisë që kanë këto zona, sepse përfiton një sasi parash në formë granti. Duhet riparë realisht si është, sepse është ndarë sipas kriterit veri-lindje ose veri-jug apo çfarëdo kriteri gjeografik që jeni orientuar ju. Faktikisht, duhet parë relievi dhe terreni që kanë njësitë administrative që janë bashkuar konkretisht në qarkun e Beratit. Shikojeni koeficientin e ndarjes së transfertës për këtë kriter.

(Diskutime pa mikrofon.)

Edhe ne nuk e bëjmë dot, sepse ai kërkon që energjinë elektrike, që është me TVSH, ta paguajë pa TVSH. Këtu e ka problemin.

(Diskutime pa mikrofon.)

Gentian Opre – Përjashtimet i bëhen botuesit që të ngarkojë në kosto çdo TVSH që paguan në blerje, duke rritur koston e produkteve. Nuk u njihet asgjë për rimbursim apo trajtime të veçanta. Mbajtja e shkallës tatimore me një përqindje të caktuar 6% bën që çdo TVSH e paguar

në blerje, të bartet në llogarinë e tyre për ta kredituar. Çdo TVSH në shitje me shkallë tatimore 6% apo një shkallë tjetër, bën që të plotësohen kushtet e ligjit për TVSH-në apo kushte të tjera ligjore, për të cilën ju lind e drejta botuesve të kreditojnë çdo TVSH të bartur kreditore.

Milva Ekonomi - A e dini sa është xhiroja e shtëpive botuese të librit në Shqipëri?
(Diskutime pa mikrofon)

Gentian Opre – Përfshirja në TVSH i bën ata të jenë më konkurrentë në treg. Këtë kërkojnë botuesit.

Milva Ekonomi - Fillojmë me miratimin nen për nen dhe në tërësi.

Kreu 1.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Të mos harrojmë te neni 1 që në diskutimet tona paraprake kërkuam që Komisioni i Ekonomisë dhe Financave të marrë në konsideratë ndryshimet që u bëhen, duke shtuar arsimin profesional dhe sportin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Transporti është rregullim, jo shtim.

Neni 3.

Ismet Beqiraj - ... profesional, shtesa e një objekti në Mallakastër.

Milva Ekonomi - Neni 3.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kreu 2. Burimet për mbështetjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit.

Neni 8.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu 3. Shpenzimet e buxhetit të shtetit.

Neni 10.

Te shpenzimet e buxhetit të shtetit, në nenin 10, kemi bërë një tabelë përmbledhëse që ia kemi çuar Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, ku kemi bërë disa vërejtje dhe kërkojmë shtesë për Radiotelevizionin Shqiptar, për QKK-në, për ATSH-në, për sportin, për arsimin profesional dhe Akademinë e Shkencave.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Miratojmë nenin 10, sepse ndryshimet nuk i kemi vetëm ne në dorë.

Neni 11.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Paga e Presidentit, që është paga referencë për të gjithë ne.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Fondi rezervë.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Jeni dakord?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ky nen është shumë i rëndësishëm për ne, sepse flet për rritjen e fondit të pagave dhe arsimit ka rritje të pagave me 7%.

Kalojmë te neni 15.

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ky nen flet për buxhetin e gjyqtarëve.

Kalojmë te neni 16. Te ky nen kemi transfertën e pakushtëzuar dhe duhet të bëjmë kujdes të shtojmë komentin tonë, sepse këtu flitet në përgjithësi për nenin, por ai është i lidhur me disa anekse, ku shpjegohen këto lëvizje. Te anekset do të bëjmë kujdes të shtojmë paragrafin e propozuar nga Flori për t'ia kaluar Komisionit të Ekonomisë.

Jeni dakord me ndryshimin e këtij paragrafi?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, për klubet. Këtë do ta specifikojmë shumë mirë për të vendosur se ku do të jetë vendi ku do të bëhet kalimi.

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17, për fondet e arsimit të lartë.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19. Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20. Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 21, që flet për eurobondin.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22, që ngarkon Ministrinë e Financave për të nxjerrë udhëzime.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Nenin 22 e miratuam pa asnjë kundërshti, por për nenin 23, që lidhet me nenin 22, kemi bërë një propozim: “Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2019.”

Ndërsa këtu thuhet: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2019.”

Ne propozojmë të bëjmë këtë përmirësim në këtë nen, që të mos kemi vonesa. Ky sugjerim që vjen nga juristi i komisionit, është: “Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2019.”

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gazmend Bici – A mund të jap një argument për këtë pjesë?

Milva Ekonomi – Po, patjetër.

Gazmend Bici – Duke qenë se projektbuxheti i vitit 2019 është përgatitur që të fillojë dhe të bëhet efektiv që në datën 1 janar dhe, para se të shkojmë këtu ka disa fakte kushtetuese, të cilat detyrojnë marrjen e disa hapave procedurale, gjë që do të thotë se Presidenti ka 20 ditë afat për të dekretuar projektligjin, janë edhe 15 ditë të tjera për hyrjen në fuqi, që bëjnë 35 ditë. Është edhe afati 5-ditor për botimin në Qendrën e Botimeve Zyrtare, që bëjnë 40 ditë. Në rast se Presidenti nuk do ta dekretonte brenda afatit kushtetues, gjë që është e drejta e tij dhe nuk e paragjykon dot, atëherë i binte që hyrja në fuqi e ligjit të ishte mbas datës 15 janar. Duke qenë se në seancë plenare është parashikuar të miratohet në datën 3 dhjetor, për t’i parapritë antikushtetueshmërisë, unë kam bërë propozimin që të merret paraprakisht miratimi i Presidentit dhe ky nen të formulohet në këtë mënyrë: “Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2019.”

Kjo procedurë është ndjekur edhe 2 vjet më parë. Është e rëndësishme që efektet financiare të fillojnë nga data 1 janar 2019. Kjo mënyrë është përdorur edhe më parë dhe më duket e nevojshme aktualisht. Më pas këtë do ta shikojnë Komisioni i Ligjeve dhe ai i Ekonomisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Do ta shikojë Komisioni i Ligjeve. Ne të bëjmë kujdes që ta propozojmë hyrjen në fuqi nga data 1 janar 2019.

A jeni dakord me këtë propozim? Përkufizimin final e jep Komisioni i Ligjeve.

Dakord. Miratohet.

Faleminderit!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji “Për buxhetin e vitit 2019”.

Mbas miratimit të projektligjit, duhet të përgatisim relacionin e komisionit, që ka kohë deri pasnesër në mëngjes. Kemi caktuar 3 relatorë që herën e kaluar. Unë mendoj që edhe për shqyrtimin nën për nën dhe atë në tërësi, të mbajmë të njëjtët relatorë: unë, Vilma dhe Ismeti. A jeni dakord?

Dakord.

Është mirë të filloni të përgatiteni që tani, për t’u bërë gati për diskutimet në seancë plenare, sepse e mbani mend që është kërkuar të flasin sa më shumë deputetë për buxhetin e vitit 2019.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, në këtë moment.

Mbyllet pika e dytë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.11.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

3. Diskutimi dhe votimi nën për nën dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” (komision për dhënie mendimi).

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Vilma Bello, Fidel Ylli, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Musa Ulqini, Besnik Baraj (zëvendësues), Anduel Xhindi (zëvendësues).

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Sezai Rrokaj.

Të ftuar:

Gentian Opre – Drejtor i Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,
Ina Dhaskali – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,
Shpëtim Shehu – drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Kulturës,
Eridana Zoto - përgjegjëse në Sektorin e Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Kulturës.

Vijon pika e tretë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Kalojmë në diskutimin dhe votimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

Dëgjuam paraprakisht Shoqatën e Botuesve. Projektligjin e kemi miratuar në parim që herën e kaluar.

Fillojmë me diskutimin nen për nen. Para se të kalojmë në votimin nen për nen dhe në miratimin në tërësi të projektligjit, a keni mundësi ju, Genti të na sugjeroni nëse do të vendosim mbrapa shërbimit të reklamave dhe medieve audiovizive dhe librave tatimin 6%?

Kjo nuk është e pjesës suaj.

Gentian Opre – Gjithsesi, kjo është në diskrecionin e Komisionit të Ekonomisë.

Milva Ekonomi – Po them nëse keni bërë ndonjë...

Gentian Opre – Të them të drejtën nuk jam në dijeni. Komunikova me këta, por ka një problem, se nuk janë njoftuar autoritetet e fiskut për mbledhjen e sotme. Ata kanë kujtuar se do të miratohej vetëm buxheti, por midis listës së çështjeve ishte edhe kjo çështje. Kërkoj ndjesë!

Milva Ekonomi – Dakord.

Po Ministria e Kulturës? Sikur ne ta vëmë këtë propozim, a keni bërë ju ndonjë studim paraprak për këtë gjë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Qëparë e ndamë projektligjin, por nuk është hera e parë që na vjen kjo letër në komision dhe ju e dëgjuat që ka 4 vjet që po diskutohet në komision kjo çështje.

Gentian Opre – Po.

Milva Ekonomi – A keni grumbulluar gjatë kësaj kohe një informacion për të pasur një ide për këtë çështje?

Gentian Opre – Ne kemi grumbulluar shumë informacion. Presim vetëm dy informacione nga INSTAT-i dhe nga Tatimet për të parë efektin financiar të uljes së tatimit në 6%. Vetëm kjo na ka mbetur.

Pjesa tjetër e projektligjit për librin, si dhe struktura organizative, që do të jetë brenda numrit të punonjësve dhe brenda buxhetit të ministrisë, janë bërë gati. Priten vetëm këto dy informacione. Ne kemi afat që brenda dhjetorit ta kalojmë për qarkullim në ministritë përkatëse.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””.

Kush është pro? Të gjithë janë dakord.

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””.

Faleminderit të gjithëve!

Ndërkohë, i mbaruam çështjet më të rëndësishme që kishim për këtë periudhë kohe.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nesër kemi një dëgjesë, nuk kemi pushim.

U lutem medieve të na lënë të vazhdojmë me punët tona!

I falënderoj shumë!

Nesër kemi për të bërë një dëgjesë, që e shtymë javën e kaluar.

E di që na ka ardhur një ftesë për disa aktivitete, por dëgjesa duhet bërë nesër. Mund ta lëmë për ta bërë dëgjesën në orët: 8, 9, 10, 11, 12, 13 të paradites.

Në 13:00 është ora më e përshtatshme?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Domethënë, nesër në orën 12:00 mund ta bëjmë dëgjesën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e shtyjmë dot, se ka një procedurë edhe ajo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A do të më thoni një orar të përshtatshëm për ju? Ora 12:00 është më e përshtatshme?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo çështje është më e rëndësishme. Më dëgjoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, e lëmë nesër, në orën 09:00-10:00.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne lidhje me trajnimin, e kemi të mërkurën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po nuk e bëjmë dot, sepse raporti duhet mbyllur dhe duhet çuar për në seancë plenare. Duhet ta bëjmë dëgjuesën nesër, në orën 09:00-10:00. Nuk diskutohet.

Përveç kësaj, të premten dhe të shtunën kemi OSBE-në dhe Butrintin. Kështu, e bëme edhe këtë listë.

E mbylлим këtu mbledhjen.

MBYLLET MBLEDHJA